Biblioletra

REVISTË E BIBLIOTEKËS KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE TË KOSOVËS

VITI 4 • NUMRI 2 • NËNTOR 2007

# "Biblioteka dhe Kujtesa Kombëtare"




*Libri më i vjetër në Koleksionet e Rralla të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, i dhuruar nga koleksionistja e njohur e librave mbi Skënderbeun – Patricia Nugge nga Londra: *Historia për jetën dhe bëmat e Skënderbeut, Princit të Epirotëve = Historia de vita et gestis Scanderbegi Epirotarum Principis* / Marin Barleti ; përkth. nga lat. në gjermanisht Joanne Pinicianu ; ilustr. piktori gjerman Breu the Elder. – Augsburg, 1533 (MDXXXIII)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, në bashkëpunim me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, më 20 - 22 nëntor 2007, në Prishtinë, do të organizojnë takimin e radhës (të dytin) të Konferencës Kombëtare të Bibliotekonomisë me titullë: *"Biblioteka dhe Kujtesa Kombëtare".*

Në këtë Konferencë, që është aktiviteti më i rëndësishëm nacional për bibliotekat, ku provohet diskursi përkushtues yni se si mund ta ruajmë trashëgiminë kulturore e ta integrojmë në një arkiv të madh, do të jenë bashkë, njohësit më të mirë të bibliotekave dhe bibliotekonomisë, hartuesit e politikave të zhvillimit e të krijimit të strategjive në institucione bibliotekare nga Shqipëria dhe Kosova, si dhe nga viset shqiptare të vendeve përreth-Tetova, Ulqini, Presheva.

Konferenca do të jetë perceptim dhe reflektim i përbashkët, ku mund ta kuptojmë vetveten dhe njëri-tjetrin, ku zbulohen mënyrat se si kuptohen gjërat e njëjta nga njerëz të ndryshëm, ku mendimi ynë ngarkohet me - maturinë për të ofruar koncepte, dhe fuqinë për t'i zbatuar ato në realitetin bibliotekar, karshi zhvillimeve të reja të teknologjisë në shkencën e bibliotekës dhe informacionit.

Në qendër të kësaj konferencë është tema *Biblioteka* dhe *Kujtesa kombëtare,* ruajtja e gjithçkasë që e dokumenton të kaluarën tonë. Biblioteka, si arkiv, si ngarkesë me histori, na referon mbrapa te jeta e botës - qysh referojnë kështu bibliotekat shqiptare histori, kulturë dhe kujtesë të përbashkët tonën, aq të fragmentuar, ku flasin dokumentet, ndërsa brenga jonë për t'i ruajtur ato bëhet normë.

Po shtohen materiale të reja, po zgjerohet një e ndodhur e përbashkët jona. Në këtë histori, teori dhe praktikë të zotërimit, organizimit dhe ruajtjes së materialit dhe informacionit *tonë,* kjo Konferencë do të ofrojë mundësi për ta planifikuar dhe kontrolluar këtë sistem mirë.

Konferenca do të nxjerrë konkluzione dhe vlerësim të nevojave për bashkëpunim, një strategji koherente për zhvillimin dhe parashikimin a të ardhmes së kulturës dhe të arkivimit të saj; sfidat e mëdha të dokumentimit dhe të ruajtjes së të dhënave të shkruara dhe të incizuara të historisë sonë.

# Java e Bibliotekës në Kosovë 2007

*Java e Bibliotekës në Kosovë 16-21 prill 2007* - aktiviteti më i rëndësishëm bibliotekar në Kosovë, u mbajt për të pestën herë që prej themelimit - në vitin 2003. Ky aktivitet, që është shndërruar në një institucion në vete me karakter ndërkombëtar, vazhdon të organizohet nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe Zyra e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë.

Edicioni i pestë i *Javës së Bibliotekës në Kosovë* u karakterizua me aktivitete të rëndësishme përmbajtjesore me interes për bibliotekat dhe kulturën në Kosovë, duke veçuar ligjërata, seminare, sesione e prezantime me pjesëmarrje të një numri të madh të ekspertëve dhe bibliotekarëve ndërkombëtarë e vendës, me tema që zgjuan interesim të publikut, si ato të: Michael Kaplan, drejtor për Produkte Digjitale (Ex Libris, ShBA): *"Përtej Aleph-it: programet bibliografike, katalogët përmbledhës, pamjet e përgjithshme të katalogëve, katalogët përmbledhës kombëtar", "Menaxhimi i përmbajtjeve digjitale për koleksionet e depoziturave për trashëgiminë kulturore dhe institucionale", "Përtej Aleph-it: Krijimi bibliografik – Amazoogle", "Mjetet bibliografike, konvertimi retrospektiv dhe katalogët shumëfunksional: si të arrijmë nga Këtu deri Atje"*; Mario Gonzalez, drejtor Ekzekutiv i Bibliotekës Greenwich (ShBA): *"Çështje thelbësore të administrimit të bibliotekave", "Filozofia dhe roli i bibliotekave publike: historia, vlerat themelore, bibliotekat publike në epokën e informacionit, bibliotekat në shoqëri shumë-etnike, programet, shërbimet për publikun", "T'u shërbesh komuniteteve të ndryshme", "Çështje buxhetore dhe të ngritjeve të fondeve", "Teknologjia e informacionit dhe e ardhmja e materialeve të shtypura"*; Jean-Arthur Creff, drejtor i Bibliotekës së NATO-s në Bruksel: *"Agjenda aktuale e NATO-s", "Zhvillimi i Depozitурës së Bibliotekës së NATO-s në BKUK".*

Ishin të rëndësishme edhe sesionet nga drejtues vendës, si ato të: Sali Bashotës (BKUK), Enver Hasanit (UP), Lawrence Corwin (Zyra Amerikane në Prishtinë), Hava Ismajli (F. Juridik), Osman Gashi (F. i Filologjisë), Besim Kokollari (QBU): *"Zhvillimi i Qendrës së Bibliotekës Universitare"*; sesioni: "*Kujtesa e Kosovës – projekt i BKUK-së*", në të cilën referuan: Sali Bashota (BKUK), Jusuf Osmani (Arkivi i Kosovës), Ibrahim Gashi (Këndi Amerikan); sesioni: *"Perspektiva e burimeve elektronike në Kosovë"*, me referime nga: Besim Kokollari (BKUK), Svetlana Breca (Zyra e ShBA-ve në Prishtinë); sesioni i organizuar nga drejtues dhe bibliotekarë të bibliotekave kryesore të Kosovës me titull: *"Llojet e veprimtarive dhe të aktiviteteve të bibliotekave publike"*

Gjatë *Javës*, gjithashtu, është organizuar sesion i veçantë: *"Krist Maloki në Kosovë"*, si dhe ekspozitë e titujve të rrallë nga Biblioteka e Krist Malokit - tashmë pronë e BKUK-së, e cila është lënë amanet nga autori që t'i dhurohet Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

Këtë vit është organizuar ekspozitë me fotografi: *Java e Bibliotekës 2003 – 2006*; ekspozitë e shkrimeve për BKUK, të gazetave të përditshme; ekspozitë: *"Kosova në harta ndër shekuj"*, e organizuar nga Zyra e Kryeministrit, Arkivi i Kosovës dhe BKUK; ekspozitë e skulpturave nga skulptorët: *Aziz Islamaj* dhe *Agim Islamaj*; gjithashtu, mbrëmje poetike me poetë të njohur nëpër qytetet kryesore të Kosovës.

Është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit mes BKUK-së dhe Arkivit të Kosovës, si dhe, në kuadër të bashkëpunimit, janë përuruar biblioteka të reja në: Viti, Fierzë; Ferizaj. Ndërsa, në *Ditën e Donatorëve*, gjatë *Javës*, nga BKUK janë dhuruar libra për bibliotekën e shkollës fillore"Faik Konica", dhe të gjimnazit të filologjisë "Eqrem Çabej", në Prishtinë.

## Në këtë numër


Biblioletra
REVISTË E BIBLIOTEKËS KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE TË KOSOVËS
Viti 4 • Numri 2 • Nëntor 2007
"Biblioteka dhe Kujtesa Kombëtare"

Vepra letrare e Mitrush Kutelit..........3
Libri në botën digjitale..........6
Intervista referale: teori dhe praktika...7
Problemet e Katalogimit në botim në BKUK..........12
Harmonizimi i terminologjisë bibliotekare në bibliotekat shqiptare..........14
Lessing: Tregimi i dikton mënyrat e rrëfimit të tij..........18

BIBLIOTEKA KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE E KSOVËS
THE NATIONAL AND UNIVERSITY LIBRARY OF KOSOVA
www.biblioteka-ks.org

**Botues:** BKUK • **Kryeredaktor i botimeve:** Prof. dr. Sali Bashota
**Kryeredaktor:** Fazli Gajraku
**Këshilli redaktues:** Besim Kokollari, Bukurije Haliti
**Realizimi kompjuterik:** Extreme Studio
**Fotoreporter:** Bashkim Binaku
**Adresa:** Sheshi "Hasan Prishtina", p.n. Prishtinë
**Tel:** ++381 38 225-605, **Fax:** ++381 38 248-940 • **e-mail:** biblioteka@biblioteka-ks.org

# Vepra letrare e Mitrush Kutelit

*(100-vjetori i lindjes së autorit)*

PROF. DR. SALI BASHOTA

## 1. VEPRA LETRARE

Vepra letrare e Mitrush Kutelit, shkrimtarit me cilësi të veçantë në letërsinë shqipe, e cila është botuar dhe ribotuar në dy periudhat e krijimtarisë së tij letrare, ndër të tjera, shtron çështje thelbësore poetike, pikërisht me stilin, temat, idetë, fabulat, figurat.

Në rrafshin tipologjizues, prozën e Kutelit, jo rrallë, mund ta emërtojmë si *prozë të ngjarjeve*, në të cilën zotëron hapësira e shtrirjes së ideve dhe domethënieve, hapësirë që përbrenda kornizës fabulare e krijon dimensionin përcaktues apo elementin përvijues që ka të bëjë me të ndodhurën. Në pikën tjetër të procedimit shihet funksionalizimi i personazheve përbrenda tekstit narrativ për të krijuar paralelizmin apo relacionin me tipin e *prozës së karaktereve*.

Me stilin e tij, Kuteli është shkrimtar i një vokacioni të veçantë në letërsinë shqipe. Duke e shkruar mjeshtërisht *rrëfenjën*, si lloj specifik letrar, ka arritur të krijojë vlera të përhershme në letërsinë shqipe. Kështu, vepra e Kutelit në prozë karakterizohet me temat e atdheut, temat e dëshpërimit social, temat për kurbetin, për gjakmarrjen, për kaçakërinë, temat e vdekjes. Diapazoni i tij i fuqishëm krijues intelektual lidhet me tregimet dhe novelat, kur i prodhon dhe i riprodhon në dy forma: në variante dhe në versione.

Po kështu, duhet thënë se kundërvënia e personazhit është një prej veçorive themelore poetike që e shquan prozën e këtij autori. Gjithsesi, në pikëpamje të procedimit dhe të zhvillimit stilistik, vepra e Kutelit shënon prirje të reja, veçan me modernitetin e rrëfimit letrar. Në aspektin ndërtimor, pos çështjes së përcaktimit llojor dhe konvencionit të kohës, në prozën e këtij autori, shihet edhe prania e hipertekstit, anotacionit, digresionit, parimi i reduktimit të narracionit, retrospektiva e ngjarjes.


*Mitrush Kuteli*

Gjithnjë përbrenda këtij pikëshikimi kritik, edhe novelat me prirje mitologjike, historike, filozofike, që bashkërisht mëtojnë të krijojnë romanin e pambaruar për Ilirinë, janë modele të veçanta shkrimi në letërsinë shqipe. Vlerë të rëndësishme ka edhe ritregimi i baladave dhe i rapsodive popullore në prozë, me çka dëshmohet për një cilësi rrëfimi mjeshtëror kutelian.

Kuteli prozator, shquhet me novelat e tij kryesore: *Vjeshta e Xheladin beut* dhe *E madhe është gjëma e mëkatit ((Tat Tanushi i Bubutimës* ). Këtu shkëlqen mjeshtëria e artit të tij në tregimtari. Është prozë që i shenjon fillet e modernitetit letrar me një rrëfim magjepsës dhe stil brilant.

Kuteli poet, dallohet me *Poemin Kosovar* dhe *Poemin e Shëndaumit*. Këtu shqiptohet ligjërimi më dramatik dhe më i dhembshëm në poezi. Gjithsesi, është domethënia më e fuqishme poetike që frymon nga një poet i Shqipërisë për njeriun e Kosovës në vitet 40 të shekullit XX. Është poezi e dhembjes atdhetare.

Kuteli kritik, shquhet me dy vështrimet e tij për poezinë e Lasgush Poradecit dhe për poezinë e Fan S. Nolit. Këtu shihet talenti i tij i veçantë edhe në kritikë. Vështrimet e tij për këta dy poetë janë ndër shkrimet më të mira në literaturën kritike shqipe.

## 2. PROZA

Tregimet dhe novelat e Mitrush Kutelit tregojnë për mjeshtrin shembullor të prozës shqipe, i cili duke funksionalizuar *tregimtarinë e largesës tematike* (me metodën prapavështruese të ngjarjes) dhe *tregimtarinë e rrëfimit të shartuar popullor* (me përpunimin e anekdotave, legjendave, gojëdhënave, baladave, miteve etj.), jo një herë, dëshmon talentin e një autori që me artin e të treguarit, me imagjinatën, fantazinë, vizionet apo misteret e botës letrare "udhëton" tërë jetën nëpër enigmën e tekstit narrativ për t'i përjetësuar konceptet e tij poetike.

Veprat e Kutelit, veçan ato në prozë, të medituara gjatë me emocionet e dashurisë djaloshare për atdheun e të thurura bukur me rrëfimet e një kodi realist, e herën tjetër modern, dëftojnë për një "histori të vërtetë", ku ndeshen realja me fantastiken (i gjalli me të vdekurin). Dhe me përshkrimin e saktë, mendimin e qartë, realitetin e shkrirë në imagjinatë, Kuteli, gjithsesi, arrin të thotë më shumë se prozatorët tjerë duke paralajmëruar fillimin e modernitetit në prozën shqipe, bashkë me Konicën, Koliqin, Migjenin.

Proza e Kutelit e parapëlqen kundërvënien e personazheve. Madje, modelet e personazheve gjithnjë lëvizin kah situata ballafaquese, aty ku mbizotëron peripecia, e pastaj thellohet konflikti. Mirëpo, veprimi i personazhit gjithmonë e bart atmosferën e ndodhur në një kohë tjetër. Është një kohë me veprim të kryer që e zbulon ndërgjegjen e karaktereve të cilat përpiqen, në radhë të parë, ta dëshmojnë vërtetësinë e ngjarjes. Në këtë pikë të përndriçimit, proza e Kutelit synon të përqafojë realizmin me kodin e tij narrativ.

Në tregimet dhe rrëfenjat ku mbizotërojnë temat e jetë-vdekjes që ndërlidhen me bestytninë, misticizmin, realen, irrealen, siç janë: *Lugertrit e fshatit tonë, I gjalli dhe i vdekuri, Rinë Katerinëza*, si dhe në novelën *E madhe është gjëma e mëkatit*, Kuteli i "zgjedh" karakteret e vullnetshme "përtej valëve të kohës", të cilat dalëngadalë ndeshen me botën irreale, me atë tragjikë misterioze të jetës ku projektohet bota e fantastikes.

Rrëfenjat e Kutelit që ndërlidhen me temën e fantastikes, ku procedohet "bota e përtejme", i gërshetojnë elementet konkrete me ato abstrakte duke i tematizuar motivet e vullnetit dhe motivet e arsyes apo dëshirën dhe mundësinë gjatë thurjes së intrigës kryesore.

Në prozën e Mitrush Kutelit karakteri i Xheladin beut është portretuar me një mjeshtëri të veçantë. Realizimi magjik, sikur bëhet parim krijues poetik që i ushqen ëndrrat letrare të Kutelit në këtë novelë. Xheladin beu është kryepersonazh i prozës së këtij autori, i cili pikturohet në rrafshin satirizues e ironik për t'u kthyer veprimi i tij në mit madje në mit që e parapëlqen heroizmin e rremë, i cili me vullnetin e tij ekstrem, pra dëshirën erotike, përballet me vuajtjen e tjetrit (Marës) duke e zgjedhur realitetin e "besueshëm", për të rënë në skajshmërinë e dinjitetit e të amoralitetit që shenjohet me incestin.

Edhe në novelën *E madhe është gjëma e mëkatit*, modeli i personazhit ka të bëjë me mitin e ringjalljes.

Tat Tanushi i modelit biblik e hyjnor e zbërthen vërtetësinë e së ndodhurës, atë legjendë ilirike të dëgjuar nëpër gojën e karaktereve fetare dhe atë shëmbëllim të përvujtnisë nga Shkrimi shenjt, ku synohet ngjallja dhe imitimi i një veprimi lutësor e predikues. Kësisoj, Shkrimi shenjt, këtu bëhet përmbajtje esenciale e rrëfimtarisë së Kutelit, ku historia, legjenda, urata, dashuria etj., bëhen tregues tematiko-motivor.

Në këtë novelë të shkruar sipas dy legjendave të dëgjuara në Pogradec, siç dëfton vetë Kuteli, flitet për një prift me emrin Tanush, i cili ungjillëzonte në një katund të Ilirisë që quhej Bubutimë. Gruaja e bukur Noemi e Galilesë shndërrohet dhe bëhet E dashura Kalije. Pra, ajo bëhet prani kryesore e mëkatit, dashurisë apo vuajtjes në kërkimet shpirtërore, psikologjike, metafizike, madje ekzistencialiste e të frytësisë.

Novelat *Në një cep të Ilirisë së Poshtme* dhe *Nga Dyrakiona në Bardhonë*, trajtojnë ngjarje dhe episode, personalitete dhe figura, që i përkasin periudhës ilire dhe helene. Në përmbajtjen e tyre, venerohen edhe shumë të dhëna gjeografike, etnografike, etnogjenetike, filozofike, sikundër edhe disa karakteristika tjera që lidhen me to: gjuha, besimet, zakonet, mënyra e jetesës, veshjet, armatimi, monumentet e artit, legjendat, mitet.

Shikuar në aspektin historiografik, këto novela mund të jenë edhe një lloj i historisë dhe i mitologjisë së letrarizuar që evokojnë përgjithësisht mbretërinë ilire të shek. IV-II para erës sonë.

Në prozën e Mitrush Kutelit, shquhet edhe ritregimi.

Pikëtakimi i poezisë popullore me prozën letrare, kallëzimi kronologjik retrospektiv i së parës dhe funksioni sendërtues kuptimor i së dytës, dëshmojnë për lidhjet e forta dhe ndikimin e ndërsjellë e reciprok të tyre në rrjedhën letrare dhe në procesin krijues. Pikërisht, në këtë rrafsh shqyrtohet karakteri dytësor poetik i baladave dhe i rapsodive popullore nga regjioni i caktuar: i Malësisë së Veriut dhe i diasporës arbëreshe, përmes të cilave tregohen legjenda të moçme dhe ngjarje që lidhen me personalitetet historike dhe mitologjike.

## 3. POEZIA

Në letërsinë shqipe Mitrush Kuteli poet, njihet me vëllimin *Sulm e lot,* veçmas me *Poemin Kosovar* dhe me *Poemin e Shëndaumit*. Po kështu, karakteristika esenciale të artit të tij poetik shihen edhe tek dy lirikat e përfshira në vëllimin *Sulm e lot*, siç janë: *Balta shqiptare dhe Po të vdes në dhe të huaj*. Kjo e fundit, gjithashtu, është njëra ndër poezitë më të mira të këtij autori. Vlerë të veçantë kanë edhe poezitë të cilat Kuteli i shkroi në fund të jetës që i përfshiu në ciklin e pambaruar *Ankthe dhe vegime*.

Poezia e Mitrush Kutelit i ndërton idetë dhe motivet, para së gjithash, duke u mbështetur në traditën poetike të rilindësve. Tematika kryesore projektohet në disa rrafshe, herë duke qenë autobiografike bashkë me paraqitjen e fenomenit të mërgimit, herë duke e shqiptuar mallin për atdheun dhe Shqipërinë e Jashtme, siç e quan Kuteli Kosovën, herë duke i evokuar ngjarjet historike apo duke i marrë veçoritë e shkrimit në trajtë të këngëve popullore. Megjithatë, frymëzimi dhe idetë e tij krijuese janë të fuqishme dhe domethënëse pikërisht në *Poemin Kosovar* dhe në *Poemin e Shëndaumit*. Kjo është faza ku shpërthejnë ndjenjat e tij të sublimuara në të gjitha variantet e shkrimit.

Autori, Dhimitër Pasko, në fjalën e tij kritike, e cila radhitet midis kurioziteteve letrare, shkruar me tri pseudonime (Mitrush Kuteli, Dr.Pas dhe Izedin Jashar Kutrulija) thotë: *Në veprën e të parit gjymon pasioni, në veprën e të dytit, pika e lotit. I pari është i ashpër, i dyti fluid lirik*. Pra, *Poemi Kosovar dhe Poemi i Shëndaumit*, zbulojnë një akt të dhembshëm të tragjikës kombëtare, atë të vuajtjes së popullit nën pushtim, por edhe një qëndresë heroike të mishëruar me idealin më të lartë të atdhetarisë.

## 4. KRITIKA

Mitrush Kuteli kritik, ka shkëlqyer në botën e letrave shqipe, veçan me interpretimet kritike për Lasgush Poradecin dhe Fan S. Nolin. Të menduarit e tij për kërkime thelbore autentike letrare, për origjinalitetin shkrimor mbeten modele interesante në kritikën letrare të derisotme.

Gjithashtu, edhe Naimi, Asdreni, Çajupi, Ali Asllani, Grameno, Hil Mosi, F. Shiroka, Migjeni e autorë të tjerë nga tradita e letërsisë shqipe, prezantohen përbrenda preokupimit

kritik të Kutelit me konceptet sqaruese e udhëzore, me një terminologji burimore të qasjes e të interpretimit kritik dhe eseistik. Duke shkruar për veprat e këtyre autorëve, Kuteli në gazetën "Shqipëria e re", që nga viti 1928 në rubrikën "Shënime letrare", që më vonë bëhet vepër e publikuar kritike, po me këtë titull, siç tregon edhe vetë e bën "me qëllim që t'u kujtojë lexonjësve disa nga vlerat tona letrare të së shkuarës". Po kështu, qasje të rëndësishme studimore dalin edhe nga shkrimet e Kutelit për autorët: M. Eminescu, T. Shevçenko, N. Gogoli, N. Ostrovski etj.

Për aktivizimin prodhimtar të një kritike recensionale, prezantuese, publicistike apo impresioniste duhet dalluar shkrimet e tubuara në kapitullin "Viti letrar 1943", në veprën "Shënime letrare", ku autori, ndër të tjera, merret edhe me probleme të aktualitetit kulturor e letrar duke i përvijuar konstatimet përbrenda një gjeografie letrare, siç e përkufizon vetë hapësirën e pranisë së shkrimit shqip.

Në këtë vazhdë të karakterizimit kritik, si tekste interesante autobiografike e eseistike duhet përmendur edhe: "Një fjalë mbi dy shokë e mbi vepërzën e tyre", që u prin poemave për Kosovën e për Shën Naumin dhe "Në Prizren midis të vdekurve dhe të gjallëve", ku vizionohet tema atdhetare dhe sipërtheksohet shqiptimi pasionant e krejt personal i Kutelit për Kosovën.

## 5. PËRKTHIMI

Në fushën e përkthimeve dhe në atë të shqipërimit, siç dëftohet nga *Kujtesa e përkthenjësit Dhimitër Pasko (M. Kuteli) për heqjen e normës së përkthimeve përgjithnjë ose të paktën për një kohë të kufizuar prej tre vjetësh*, ky autor "i transferuar" në Shtëpinë Botuese "Naim Frashëri", përktheu veprat: nga letërsia ruse dhe sovjetike, nga letërsia rumune, nga letërsia kineze; nga letërsi të ndryshme të botës përktheu tregime arabe, tregime persiane, tregime turke, tregime mongole etj.

Edhe në përkthimin e veprave "të detyrueshme për normën", Mitrush Kuteli dëshmon kulturën e tij shkrimore, dijen e sistemuar në fushën e letërsisë, të kritikës e të mendimit estetik.Duke qenë njohës i pasionuar i gjuhës dhe një nga stilistët më të mirë të letërsisë shqipe, Kuteli arriti që edhe gjatë përkthimit të këtyre veprave të tregojë mjeshtërinë e tij.

Në fushën e përkthimeve duhet dalluar veprat e autorëve rusë dhe rumunë të cilat gjatë shqipërimit shkëlqejnë në penën e Kutelit. Mbi të gjitha, shquhen veprat e N. V. Gogolit: *Frymë të vdekura dhe Tregimet e Petërsburgut* dhe vepra *Tregimet e një gjahtari* të I. Turgenievit. Nga letërsia rumune shquhet sidomos shqipërimi i vjershave të Mihail Emineskut.

Përkthimet e M. Kutelit së bashku me ato të Lasgush Poradecit, në radhë të parë, e pasurojnë fushën e përkthimeve artistike në literaturën shqipe. Për metodën, mjeshtërinë, stilin etj., shqipërimet e këtyre dy autorëve janë modele interesante për shkollën shqiptare të përkthimit.

## 6. TESTAMENTI

Testamenti, letra e fundit e Kutelit, adresuar gruas dhe fëmijëve është teksti më i dhembshëm i tij që i kapërthur situatat e fundjetës në një gjendje ku meditohet për vdekjen, madje si në ëndërr të llahtarshme përvijohen së bashku: vetmia, halucinacioni, ikja, vuajtja, dhembja, ndjekja, tradhtia, vrasja...

Kështu, testamenti i Kutelit e kuptimëson poetikisht e përjetësisht kohën e dhembjes krijuese, jetësore, ekzistenciale të shkrimtarit në çastin më përfytyror të vdekjesimit. Është një dialogim i habitshëm në raportin: *ego-alterego*, në kacafytje të përthellë me jetë – vdekjen, ku zatetet emocioni dhe arsyeja përbrenda ritualit të pagjumësisë apo të ëndrrave të liga, herën tjetër.

Testamenti i Kutelit është një alegori e fortë për aktualitetin jetësor, njerëzor, shoqëror, por edhe letrar në kohën kur është shkruar. Edhe pse e vijëzon edhe të kaluarën e shkrimtarit, domethënia letrare e kritike e tij, përqendrohet në një kohë të përjetuar me aktivizimin e një akti qëllimor si porosi, amanet për gruan, për fëmijët, për rrethin, edhe atëherë kur gërshetohen faktet letrare me të ndodhurat jetësore.

Në rrafshin tjetër të domethënies mesazhi esencial ngulitet përbrenda konceptit qendror të këtij atdhetarizmi e dashurie ndaj gjakut të vet, trashëgimisë: "Fëmijët i porosit ta duan vendin dhe gjuhën tonë gjer në vuajtje. Të mos u shqasë zemra kundër Shqipërisë kur do të vuajnë pa faj. Atdheu është atdhe, bile edhe atëherë kur të vret".

Gjithsesi, ky është një sublimacion i një vetëdijësimi kritik, madje suprem e mrekullitar i qasjes atdhetare e krijuese kuteliane në këtë formë rrezatimi kuptimor, i papërsëritshëm në letërsinë dhe kulturën shqipe.

## 7. NË VEND TË PËRFUNDIMIT

Mitrush Kuteli me veprën e tij letrare është njëri nga autorët më të rëndësishëm të letërsisë dhe të kulturës shqipe. Prozator, poet, kritik, përkthyes etj., Kuteli shquhet, para së gjithash, me veçantinë e tij krijuese: me idetë, temat, përshkrimet, monologët, dialogët, kompozicionin, stilin. Pra, vepra e tij letrare tregon për individualitetin letrar që në rrjedhat fillimtare të modernitetit në letërsinë shqipe.

Thelbi i artit të tij është tregimi. Kuteli dyzet vjet pandërprerë e ka shkruar *rrëfenjën* si lloj të ri letrar. Proza e tij ka arritur të krijojë vlera të larta në letërsinë shqipe, pikërisht me gjuhën poetike dhe me funksionalizimin e rrëfimit letrar.

Mjeshtëria e shkrimit të këtij autori mbështetet tek stili. Kuteli është një ndër stilistët më të shquar të prozës shqipe, i cili shprehjes letrare dhe mendimeve të tij u jep fuqi krijuese duke i përsosur dhe sublimuar poetikisht. Gjuha e prozatorit, e vjelë nga thesari i pasur i Pogradecit, funksionalizohet në shtresat kuptimore të rrëfenjave të tij dhe bëhet gjuhë e nivelit të lartë dhe të figurshëm. Prandaj, në kërkimet dhe realizimet e tij krijuese, Kuteli gjuhës i kushton rëndësi të veçantë dhe në këtë pikëpamje është origjinal.

Është koha që brezat e rinj të lexuesve t'ju rikthehen autorëve të mëdhenj shqiptarë, siç është edhe Mitrush Kuteli, për t'i njohur vlerat elitiste letrare.

*(Kumtesë e lexuar në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, me rastin e shënimit të 100-vjetorit të lindjes së Mitrush Kutelit, Prishtinë, 17 gusht 2007)*

# Libri në botën digjitale

*“Të shkruash është qëllimi më i madh i jetës, se vlera supreme është libri”*
Borges

*“Bota ekziston për me dalë te një libër”*
Malarmé

ETLEVA DOMI[*]

Tani, rreth gjashtë shekuj larg nga shpikja e Gutenbergut, në epokën e kibernetikës dhe internetit, të botës së virtualitetit, të modernitetit virtual, të lirisë së informimit- shprehjes-përzgjedhjes, të erës së librarive-katalogëve-bibliotekave digjitale, një nga temat më të debatuara në mjediset e editorisë elektronike, shkencore dhe mediatike, është ajo që ka të bëjë me të ardhmen e librit, debat që përgjatë së paku 10 vjetëve të fundit ka tër¬he¬qur një numër të madh njerëzish prej të gjithë kon¬tinenteve dhe të gjithë horizonteve kulturore. Krijimi i “autostradës” informatike, i hiperteksteve digjitale, përsosja e motorëve të kërkimit, zhvillimi spektakolar i siteve web etj., janë tregues të zhvillimit dhe aplikimit të vrullshëm të teknologjive të reja. Por, kur reflektohet mbi marrëdhëniet ndërmjet teknologjive dhe kulturës, vendin kryesor pa dyshim e zë librimjeti parësor i depozitimit dhe transmetimit të dijes. Prandaj është e natyrshme të shqetësohemi kur dëgjojmë lajme tronditëse për “zhdukjen” e librit. Libri është Trashëgimia jonë pasi ai është para së gjithash simbol i qytetërimit, i kulturës, i dijes. Libri ka ekzistuar prej mijëvjeçarësh dhe do të qëndrojë në shekuj. Në shekullin XXI të gjithë duhet të jemi të vetëdijshëm se libri është çështje e gjithëkohshme dhe se ai mbetet një mjet i pazëvendësueshëm për zhvillimin e kulturës kombëtare të çdo populli. Gjithnjë e më shumë sot po zbulohen dhe vlerësohen shumë anë të botës së tij: libri si vektor vlerash dhe dijesh, por edhe si



depozitues trashëgimie jomateriale; libri si dritare e hapur mbi ndryshmërinë e kulturave dhe si mjet dialogu. Ndonëse sot media moderne ka marrë rolin e përhapjes së informacionit, librat janë akoma burimi i ideve që ndryshojnë mendësitë e njerëzve. Për këtë të fundit është e nevojshme të thuhet diçka më shumë. Nuk duhet harruar që shumica e lëvizjeve të mëdha në të gjithë botën kanë lindur për shkak të një libri të çfarëdolloj dhe se ai është mjeti kryesor nëpërmjet të cilit transmetohen e përhapen idetë. Profetët e së keqes, të cilët paralajmërojnë zhdukjen e librit, në periudha të ngjashme ndryshimesh teknologjike kanë propaganduar të njëjtën gjë. Mjafton të kujtojmë periudhat e shpikjes së kinemasë, radios, televizionit etj. Edhe me shfaqjen e medias moderne, librat nuk rrezikojnë zhdukjen. Ndonëse numri i përdoruesve të internetit është gjithnjë në rritje, të paktë janë ata që parapëlqejnë leximin nga “instrumente elektronikë”. Në epokën e përpjekjeve mbarëbotërore për krijimin e “bibliotekave virtuale”, e-books-eve etj. nuk do të humbasë kurrë komoditeti i të mbajturit në dorë të librit, nuk do të zhduket asnjëherë emocioni i të prekurit të librit, i kontaktit të drejtpërdrejtë me origjinalin, i kënaqësisë estetike të kopertinës, aromës së tij… Është për të ardhur keq që pikërisht kjo gjë ende nuk po kuptohet nga ata që vijojnë të shpenzojnë mjaft për libra elektronikë, që vijojnë të lexojnë botimet në ekrane ose t’i shkarkojnë prej tij, disfatë, që ka filluar të bëjë bujë. Baza elektronike është sa e sofistikuar, aq edhe “delikate”. Dhe do vijë një ditë që një tjetër instrument elektronik do të shfaqet, por nuk mund të imagjinoj kurrë heqjen e librave nga raftet e bibliotekave tona, madje as edhe nga ato të fëmijëve tanë. Por, siç duket, as teknika e as mentaliteti nuk kanë qenë të gatshme për të lejuar suksesin që kjo botë po ofron. Duhet të pohojmë që nuk bëhet fjalë për dilemë. Liria dhe shoqëria demokratike kanë lindur pikërisht në kulturën librore dhe pa libra zhvillimi i qytetërimeve do të kishte qenë krejt i pamundur. Për këtë kërkohet integrimi i një bote të re të dijeve e komunikimit në kulturën tradicionale librore. Është e kuptueshme që, më shumë se asnjëherë, libri është shoqëruesi i domosdoshëm i ndryshimit. Të gjithë kemi nevojë “për qetësinë e librit”. Besoj në pavdekësinë e librit, besoj në të ardhmen e tij.

---

[*] *Autorja është zëvendësdrejtore e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë. Ky shkrim ekskluziv është shkruar për revistën Biblioletra*

# Intervista referale: teori dhe praktika



Stephanie Willen Brown

* *Stephanie Willen Brown është Bibliotekare e Burimeve Elektronike dhe kujdeset për Departamentitn e Shkencave të Komunikimit në Universitetin e Konektikut, në Storrs, Connecticut, ShBA. Jeton në pjesën perëndimore të shtetit Massachusetts, ku edhe jep mësim në Kolexhin Simmons të Shkencave të Bibliotekarisë dhe Informacionit. Stephanie ligjëron lëndën ''Hyrje në shërbimet referale" si dhe lëndë të tjera që i përkasin menaxhimit të burimeve elektronike.*

*Ky shkrim ekskluziv është shkruar për revistën Biblioletra*

- Më nevojiten informacione për kancerin e gjirit
- Jam duke shkruar një punim për kolonializmin në veprën e Shekspirit "Stuhia"
- A e keni gazetën "Time"?
- Si formohen retë? Cilat re prodhojnë shi?

Këto janë disa nga pyetjet të cilat u drejtohen bibliotekarëve të cilët punojnë në tavolinën e referencës. Nganjëherë disa pyetjeve u gjendet përgjigje e shpejtë, ndërsa të tjerat duken të lehta, por në të vërtetë kërkojnë kohë dhe detaje. Këto pyetje mund të jenë të vështira për t'u gjetur përgjigje një bibliotekar i sapo-punësuar, mirëpo bëhen më të lehta me kalimin e kohës dhe fitimin e përvojës. Detyra kryesore e bibliotekarit referal është që të dijë ta interpretojë pyetjen e përdoruesit në një pyetje të cilës mund t'i gjendet përgjigje përmes burimeve të cilat i zotëron biblioteka. Unë ofroj shërbime referale për studentët në studime themelore dhe ato pasuniversitare në Bibliotekën e Universitetit të Konektikut, në Departamentin e Shkencave të Komunikacionit; po ashtu jap lëndën 'hyrje në shërbimet referale' në Kolexhin Simmons të Shkencave Bibliotekare dhe të Informacionit në Sauth Hadley, Massachusetts, SHBA. Bibliotekarët përdorin disa strategji për t'u ndihmuar përdoruesve në pyetjet e tyre; unë i përdori ato si - në praktikë, në punë, ashtu edhe kur jap mësim në klasë. Elementi kryesor është që të dimë se çfarë dëshiron përdoruesi, e cila mund të jetë më e vështirë se sa duket; elementi i dytë është që të dimë se çfarë burime zotëron biblioteka dhe si t'i përdorim ato.[1] Ky artikull përqendrohet në atë se si të përcaktohemi se çfarë informacioni i duhet përdoruesit përmes intervistës referale.

## PËR PËRDORUESIN

Së pari duhet të dimë se kush është "përdoruesi". Mbase ju do t'i njihni përdoruesit në bibliotekën tuaj, mirëpo ata ndryshojnë nga biblioteka në bibliotekë, e madje edhe brenda vetë bibliotekës tuaj. Për shembull, gjatë punës në bibliotekë mund të komunikoni me një student në studime themelore apo pasuniversitare, apo edhe një nxënës të shkollës së mesme. Mund të vijë edhe ndonjë prej fqinjëve tuaj apo ndonjë zyrtar qeveritar. Kjo situatë mund të jetë në një bibliotekë publike, e hapur për përdoruesit e secilit profil, apo mund të jetë në një bibliotekë shkolle apo universitare. Në Shtetet e Bashkuara, ju mund të jeni të punësuar edhe në ndonjë bibliotekë të veçantë (të spitalit, gazetave, korporatë të njohur). Pa marrë parasysh llojin e përdoruesit apo të bibliotekës, ju do t'u qaseni secilit prej tyre në mënyrë të njëjtë, porse ju ofroni materiale të ndryshme. Le të mendojmë pak për pyetjen e parë të cilën e parashtruam në këtë artikull: përdoruesi kërkon "informacione për kancerin e gjirit".

[1] Të mësosh se si të përdoren burimet e bibliotekës, dhe se cilat burimet të tjera mund të gjenden është shumë e rëndësishme, mirëpo është përtej synimit që shtjellohet në këtë artikull. Në lëndën "hyrje në referencë", u mësoj studentëve se si të japin shërbime të mira referale si dhe shpalosi para tyre mbi 300 burime të rëndësishme referale. Studentët fillojnë të mësojnë për këto burime në klasë, mirëpo procesi i të mësuarit vazhdon gjatë tërë karrierës së tyre për arsye se burime të reja dalin, por edhe per shkak se përdoruesit parashtrojnë pyetje të cilat kërkojnë përgjigje në burime të reja.

Përgjigja e kësaj pyetje mund të ndryshojë me të madhe varësisht se kush është përdoruesi. Për shembull, nëse përdoruesja është studente e biologjisë në studime pasuniversitare, duke studiuar kancerin, nevojat e saj janë studimore, shkencore, informacione të reja si dhe të hollësishme, ndërsa po qe se përdoruesja është në shkollë të mesme, e cila është duke shkruar një punim për llojet e ndryshme të kancerit, asaj i nevojiten ndoshta materiale me më pak hollësi. Ju, si bibliotekar, do të merrni një qasje krejtësisht të ndryshme po qe se përdoruesja është motra e ndonjë të mbijetuarit nga kjo sëmundje, apo nëse përdoruesja sapo është diagnostikuar me kancer të gjirit. Në situatën e dytë, ju duhet të jeni më të ndjeshëm se sa qasja e tipit të biznesit me të cilin do t'u drejtoheshit studentëve, si dhe ju do të ofroni materiale më pak studimore, por më shumë të orientuara kah aspektet shëndetësore të klientëve. Po ashtu, mund të ndodhë që ju jeni duke i ndihmuar një zyrtari qeveritar, i cili dëshiron të dijë statistikat e fundit sa i përket kësaj sëmundje: sa njerëz diagnostikohen çdo vit, cila është shkalla e të mbijetuarve, si dhe cila është kostoja e trajtimit të saj. Nga ky shembull i vetëm, mund të shihet se sa komplekse mund të jetë ndihma që ju i ofroni përdoruesit përmes një pyetje e cila duket e thjeshtë në fillim.

Elementi tjetër, i cili duhet të kihet parasysh, është koha brenda së cilës përdoruesi kërkon përgjigje. Në Shtetet e Bashkuara, është e zakonshme që studentët të vijnë te tavolina e referencës një ditë para se ta dorëzojnë punimin e tyre, dhe kërkojnë informacione të hollësishme për temën e tyre (kolonializmi në veprën e Shekspirit "Stuhia", për shembull); përderisa ne mund t'u ndihmojmë studentëve në këtë minutë të fundit, ne nuk mund t'u sigurojmë materialet më të përshtatshme në këtë çështje. Në Universitetin e Konektikut (ang: University of Connecticut) i posedojmë disa baza të dhënash me tekst të plotë, të cilat janë "mjaft të mira" dhe u hynë studentëve në punë për të gjetur artikuj me informacione të mjaftueshme për të shkruar punimet e tyre. Megjithatë, po qe se jemi duke u ndihmuar studentëve pasuniversitarë, të cilët janë duke shkruar tezën e disertacionit në temën e njëjtë, materialet me epitetin "mjaft të mira" nuk mjaftojnë në këtë kontekst. Në një situatë ideale, ne do t'u vinim në ndihmë studentëve në studime themelore gjatë fazës së hershme të hulumtimit të tyre dhe do t'u mësonim të gjitha burimet të cilat do të ishin të dobishme gjatë procesit të hulumtimit, duke përfshirë baza të dhënash, indekse në temën të cilën e shtjellojnë, duke gjetur materiale të shtypura në bibliotekë, si dhe duke kërkuar libra nga biblioteka të tjera. Bibliotekarëve dhe arkivistëve në Shtetet e Bashkuara shpesh u bie të punojnë me përdoruesit të cilët bëjnë hulumtime për historikun e familjeve të tyre. Përdoruesja e cila kërkon trungun e vet familjar shpesh kalon vite në hulumtimin e saj; ajo nuk do të kënaqet me një burim, i cili është "mjaft i mirë".

## PYETJA E VËRTETË E PËRDORUESIT

Sapo i kemi diskutuar dy elemente të cilat duhet të kihen parasysh për përdoruesin me rastin e ofrimit të ndihmës për t'u gjetur përgjigjet e pyetjeve të tyre. Kjo na jep një informacion të mirë, por ne duhet të përcaktojmë edhe nevojën reale për informacion të përdoruesit. Siç e kemi parë, ekzistojnë disa lloje të materialeve që mund t'i dëshirojë përdoruesi po qe se kërkon "informacione për kancerin e gjirit". Ta shqyrtojmë edhe një situatë tjetër: një student i shkollës së mesme e pyet bibliotekarin referal në një bibliotekë publike për numrin më të ri të gazetës "Time". Bibliotekari do të mund thjesht të dëftojë me "ja atje" dhe t'i japë përdoruesit atë çfarë e ka kërkuar në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Çfarë nëse pyetja nënkuptuese e studentit ka qenë tjetër? Çfarë - po qe se studenti ka qenë duke e bërë një punim sa i përket luftës në Irak dhe ka dashur artikuj të cilët e përshkruajnë prezencën e Shteteve të Bashkuara në Irak, pjesëmarrjen e vendeve të tjera në luftë, si dhe mendimin e tanishëm (si atë brenda vendit, po ashtu edhe atë ndërkombëtar) sa i përket luftës? Në mendjen e studentit, gazeta si "Time" boton artikuj sa u përket atyre çështjeve dhe ka artikuj në temën të cilën dëshiron ta shtjellojë. Mirëpo, në realitetin bibliotekar, të shfletosh përmes numrave të tanishëm të gazetës "Time", nuk do të sjellë medoemos artikuj të dobishëm. Në fakt, të shfletosh përmes numrave të tanishëm të gazetave, nuk është mënyra më e shpejtë e kërkimit. Për më tepër, profesori i studentit mund të ketë kërkuar që studentët nuk do të mund të citojnë nga gazetat popullore, të tillë si "Time"; profesori mund të kërkojë nga studentët të lexojnë artikuj nga revistat shkencore, të tilla si "Foreign Policy", apo revista "Journal of Conflict Resolution".

Një situatë tjetër e mundshme mund të jetë që studenti ka dëgjuar për një seri artikujsh të botuar në gazetën "Time", (apo ndoshta në gazetën "Newsweek") sa i përket ushtrimeve dhe shëndetit. Studenti nuk dëshiron të duket i paqartë në pyetjen e tij, kështu që, në vend që t'ia paraqesë bibliotekarit pyetjen ashtu të paformuluar mirë, ai e pyet drejtpërdrejt për numrin më të ri të gazetës "Time". Në të vërtetë, artikujt për të cilët ka dëgjuar studenti, janë botuar në gazetën "Newsweek" tre muaj më parë. T'ia dëftosh studentit se ku është i vendosur në raft numri më i ri i gazetës "Time", në këtë

situatë, mund t'i mos i ofrojë studentit përgjigje në pyetjen e tij, e posaçërisht nëse biblioteka i vendos numrat më të rinj të një gazete në një raft tjetër prej numrave të asaj gazete të botuar tre muaj më parë.

Prandaj ekziston një konflikt thelbësor mes asaj se çfarë pyet studentit dhe materialit, i cili do t'i ofronte përgjigjen e duhur në pyetjen tij. Studenti mund edhe të mos e dijë se cila është pyetja e tij e vërtetë; ai mund të besojë se po të lexojë gazetën "Time", do t'i ndihmojë në punimin e tij. Ai mund të dijë që gazeta "Time" nuk është burimi i duhur, por mendon që duke e shfletuar atë, do të gjejë burime të tjera që do t'i hynë në punë. Ai mund të dijë që gazeta "Time" është burimi i gabuar, por frikësohet të paraqitet i padijshëm para bibliotekarit dhe kështu parashtron një pyetje të atillë që nuk e bën të ndjehet i padijshëm. Përfundimisht, mund të jetë e vështirë për studentin që të artikulojë në mënyrë të saktë atë se çfarë ka nevojë (ndoshta edhe mund të mos e dijë atë!), kështu që parashtron një pyetje për të cilën beson se do ta ofrojë më afër asaj që dëshiron, dhe shpreson se do të mund t'i bijë në fije kur të ketë qasje në informacionin e kërkuar.[2]

Jam e mendjes që është detyrë e bibliotekarit referal që të parasheh këtë konflikt thelbësor të mundshëm dhe t'i bëjë studentit "pyetje sqaruese" sa i përket kërkesës së tij fillestare gjatë procesit të intervistës. Fjalori i Shkencave të Bibliotekarisë dhe Informacionit (Online Dictionary for Library and Information Science - ODLIS) jep këtë përkufizim sa i përket "intervistës referale":

"Një komunikim ndërpersonal, i cili ndodh mes bibliotekarit referal dhe një përdoruesi të bibliotekës, për të përcaktuar nevojën (nevojat) specifike për informacion të atij personi, që mund të ndodhë të jetë krejtësisht e ndryshme në krahasim me pyetjen referale të bërë në fillim. Për shkak se përdoruesit shpesh mund të janë të rezervuar, veçanërisht në komunikimin ballë për ballë, atëherë mund të kërkohet durim dhe takt nga ana e bibliotekarit. Një intervistë referale mund të ndodhë kur përdoruesi vjen në bibliotekë, përmes komunikimit me telefonit, apo në mënyrë elektronike (zakonisht përmes adresës elektronike) me kërkesën e përdoruesit, mirëpo një bibliotekar i aftësuar mirë do të fillojë komunikimin po qe se një përdorues, i cili ngurron, duket se ka nevojë për ndihmë".[3]

Zhvillimi i intervistës referale paraqet detyrën më të rëndësishme të bibliotekarit referal, sepse kjo mundëson që bibliotekari të mund të gjejë burimin e duhur dhe relevant për t'iu përgjigjur pyetjes së përdoruesit.

## INTERVISTA REFERALE

Shoqata e Shërbimeve Referale dhe për Përdorues (Reference and User Services Association - RUSA) pjesë e Shoqatës së Bibliotekave Amerikane ka krijuar "udhëzimet për mënyrën e sjelljes dhe të kryerjes së detyrës nga ofruesit e shërbimeve referale dhe të informacionit", të cilat ofrojnë pesë elemente të rëndësishme, apo faza, të intervistës referale:

1. Mënyra e qasjes
2. Interesimi
3. Të dëgjuarit/ të pyeturit
4. Kërkimi
5. Përcjellja e progresit pas kërkimit[4]

**Mënyra e qasjes** ka të bëjë me një pritje të mirë ndaj përdoruesit: ju duhet ta bëni përdoruesin të ndjehet se mund t'ju parashtrojë pyetje. Në Shtetet e Bashkuara, është me rëndësi që të shikojmë drejt në sy si shenjë respekti me rastin kur përdoruesi afrohet. Po ashtu është mirë që të qohemi në këmbë, ta përkulim kokën në drejtim të përdoruesit, apo ndonjë shenjë tjetër e cila shpreh dëshirën tuaj për t'iu përgjigjur pyetjeve të tyre. Unë i mësoj studentët e mi të krijojnë përshëndetje standarde për të filluar intervistën referale, të tilla si "A mund t'ju ndihmojë?", "A keni ndonjë pyetje?", apo "A po mund të gjeni atë të cilën po e kërkoni?" Ju nuk duhet të dukeni se jeni shumë i/e zënë pasi që përdoruesi do të ngurrojë të ju ndërpresë në punën tuaj. Kjo duket si një arsye e mirë, edhe është e tillë – mirëpo ekzistojnë shumë rrëfime (të botuara dhe gojëdhëna) kur përdoruesit e kanë ndjerë se bibliotekari ka qenë shumë i zënë ose nuk ka shpreh dëshirë që t'u përgjigjet pyetjeve të tyre. Si bibliotekarë duhet të jemi të vetëdijshëm për imazhin të cilin e përçojmë te përdoruesit kur ata

[2] Një analogji për mua do të ishte si kur të blesh verë. Nuk e di se si të blej verë: Nuk e njoh terminologjinë teknike për shijet e ndryshme të verës, nuk di se si të zgjedh verën e cila më pëlqen. E di se çfarë më pëlqen apo se çfarë nuk më pëlqen – por vetëm kur do ta shijoj atë! Bie në mëdyshje kur duhet të zgjedh verën të cilën do ta pimë për darkë. Nuk dëshiroj të bëj ndonjë pyetje pasi që shitësi mund të mendoj që unë jam e padijshme, dhe (në skenarin më të keq) do të refuzojë të më shesë verë. Kështu, në vend që të kërkoj ndihmë, apo të mësoj më shumë për verën (në këtë mënyrë nuk dëshiroj të mësoj më shumë; dëshiroj vetëm të blej ca verë e cila më pëlqen), kështu unë vetëm marr një shishe verë, duke shpresuar se do të jetë shija që e kam në qejf. Procesi im i blerjes së verës është i ngjashëm me atë se si ndjehet përdoruesi kur mendohet të kërkojë ndihmë nga bibliotekari.

[3] Reitz, Joan M. "Reference Interview"nga Online Dictionary for Library and Information Science (ODLIS). Vizituar më 5/1/07, në: http://lu.com/odlis/odlis_r.cfm#refinterview.

[4] MOUSS Management of Reference Committee, Reference and User Services Association. "Guidelines for Behavioral Performance of Reference and Information Service Providers", updated 2004. Vizituar përmes faqes së Internetit të Shoqatës Amerikane të Bibliotekave (American Library Association) më 4/30/07 në: http://www.ala.org/ala/rusa/rusaprotools/referenceguide/guidelinesbehavioral.htm

për herë të parë ballafaqohen me ne.

Elementi tjetër i intervistës referale është vazhdimësia e të qenit i afërt; ju do të dëshironi të dukeni **i interesuar** në pyetjen të cilën e parashtron përdoruesi. Shpesh në punën time u tregoj përdoruesve në mënyrë të hapur se pyetja e tyre është interesante (kjo zakonisht është e vërtetë – si bibliotekare, kënaqem të dëgjoj nevoja të ndryshme për informacion të përdoruesve dhe shpesh hulumtimet e tyre janë magjepsëse). Për mua, kjo është mënyra për të shfaqur interesin tim për temat e tyre, por kjo më jep vetëm ca kohë përderisa mendoj se cilat burime apo pyetje shtesë që duhet të bëj janë të përshtatshme gjatë procesit të intervistës referale. Për shembull, së voni i kam ndihmuar një studenti në studime pasuniversitare të inxhinierisë ambientale, i cili po hulumtonte rritjen e reve dhe mënyrat për të paraparë nëse retë do të prodhojnë lagështi (shi, borë, kokërriz, etj.). Kjo temë ishte edhe intriguese edhe sfiduese pasi që unë nuk jam e njohur me literaturën sa i përket studimeve të reve. Prandaj, i shfaqa përdoruesit interes të vërtetë në temën e tij, e kjo më dha pak sekonda që të mendoj se si të shkoj më tej me hulumtimin e tij.

Së fundi, në fazën e tretë, ne jemi të gatshëm t'i bëjmë përdoruesit "**pyetje sqaruese**", të cilat do të na shpijnë në zemër të nevojës së tij për referenca dhe **të dëgjojë** reagimin e tij. Studenti i inxhinierisë dëshironte materiale të cilat ofronin informacione nëse retë do të gjeneronin lagështi. Detyra ime e radhës ishte që të gjeja se për çfarë informacione kishte nevojë, dhe se çfarë kishte gjetur deri tani. Po qe se do të ishte në fillim të hulumtimit të tij, ndoshta do t'ia kisha shpjeguar bazat e të dhënave të bibliotekës dhe do të fillonim me një kërkim të thjeshtë në temën e tij. Po qe se do të dëshironte të bënte një kërkim më të saktë të asaj që ai tashmë kishte bërë, do të filloja me një fazë më të avancuar të procesit. Në këtë rast, ai dinte mjaft shumë sa i përket temës së tij dhe se kishte botuar një artikull në lidhje me të. Megjithatë, ai kishte bërë hulumtime vetëm në shkallë të gjerë, duke kërkuar në bazat e përgjithshme për shkencën dhe duke shikuar citate në fund të artikujve të cilët i kishin pëlqyer. Ai nuk kishte bërë ndonjë kërkim specifik në bazat e të dhënave të inxhinierisë.

Prandaj, i bëra disa pyetje se ku kishte bërë kërkim. Udhëzimet e Shoqatës për Shërbime Referale dhe për Përdorues sugjerojnë disa lloj pyetjesh që mund t'i bëjmë përdoruesit, të tilla si "Çfarë keni gjetur deri më tani?", "Për çfarë lloji të informacionit keni nevojë (libra, artikuj, etj.)?", dhe "A ju nevojiten informacionet më të reja apo historike?" Studenti im më shpjegoi se çfarë kishte gjetur deri më tani, duke më treguar se si e kishte bërë hulumtimin; ai shtoi se kishte nevojë për artikuj të rinj për temën e tij. Megjithatë, pasi që nuk kishte bërë ndonjë kërkim në literaturën e inxhinierisë, i sugjerova se ndoshta do të ketë nevojë edhe për ca artikuj më të vjetër, pasi që kisha bindjen se ai nuk kishte bërë ndonjë kërkim të hollësishëm në temën të cilën po e shtjellonte.

Përderisa detyra për të bërë këso lloj pyetjesh provuese duket e lehtë, në të vërtetë është më e vështirë se sa duket. Unë u ofroj studentëve të shkollës së mesme, të cilët kërkojnë ndihmë, disa pyetje të cilat zbatohen në situata të ndryshme referale. Disa prej tyre përfshijnë pyetje të hapura si "Çfarë keni bërë deri më tani për temën tuaj?" dhe "A mund të më tregoni pak më shumë për të?" Pyetjet e tipit të hapur shpesh janë më të mira për përdoruesit për arsye se i inkurajojnë ata të japin më shumë hollësi e jo thjesht një përgjigje 'po' ose 'jo' të cilën do ta merrnit po të bënit pyetje të tipit të mbyllur. T'i bësh përdoruesit që të japin më shumë hollësi është shumë e dobishme kur ju përpiqeni që të gjeni sa më shumë informacione për temën e tyre. Në rastin kur unë nuk e njoh temën e përdoruesit, shpesh thamë "Sa interesante! A mund të më tregoni pak më shumë për të?" Kjo u tregon përdoruesve që jo vetëm se jam e interesuar në temën e tyre, por edhe i inkurajon që të më japin më shumë hollësi për temën, kështu që mund të jap kontributin tim sa më mirë. Një pyetje tjetër, posaçërisht e dobishme për studentët të cilët bëjnë hulumtime teknike, është "a mund ta shqiptoni shkronjë për shkronjë atë?" Po qe se një student tregon se është duke e kërkuar një libër të veçantë, do t'i bëj një pyetje të tipit të mbyllur, si "a ke kërkuar në katalog të bibliotekës?" për shkak se dua të sigurohem nëse kanë bërë kërkim në katalog para se të fillojmë kërkimin tonë së bashku. Megjithatë, në situata të tjera pyetjet e tipit të mbyllur nuk u ofrohen për nga dobia pyetjeve të tipit të hapur.

Kjo na shpie në fazën e katërt të intervistës referale të paraparë në udhëzimet e Shoqatës së Shërbimeve Referale dhe për Përdorues – **bërjen e kërkimit.** Mund të tingëllojë e çuditshme që Shoqata e Shërbimeve Referale dhe për Përdorues nuk rekomandon të fillohet me kërkimin e vërtetë deri në fazën e katërt të procesit, mirëpo nëse kthehemi prapa dhe e kujtojmë pyetjen sa i përket gazetës "Time", mund të kuptojmë që një përgjigje e drejtpërdrejtë në pyetjen e përdoruesit ("Numrat e rinj të gazetës janë të vendosur aty") mund të mos jetë përgjigjja më e mirë për përdoruesin. Mirëpo, në fazën e tretë, ne e përcaktuam që përdoruesi është i interesuar për informacionet

më të reja sa i përket luftës në Irak, dhe kështu ne bëjmë kërkimin në bazën e të dhënave, i cili do të ofrojë artikuj nga periodikë të përgjithshëm për t'iu përgjigjur pyetjes së tij të vërtetë. Në këtë fazë, i tregova studentit tim "të reve" një bazë të rëndësishme të të dhënave të fushës së inxhinierisë. Para se të fillonim me kërkimin, ia shpjegova vlerën e kësaj baze dhe e theksova faktin se ai si student i inxhinierisë ambientale, duhet të njihej me materialet të cilat gjinden në këtë bazë.

Faza e fundit e intervistës referale në udhëzimet e Shoqatës për Shërbime Referale dhe për Përdorues është **përcjellja e progresit pas kërkimit.** Kur intervistës referale fillon t'i vijë fundi, shpesh i bëj pyetje përdoruesit "a ju hyn kjo në punë?" apo "a do të jetë kjo e mjaftueshme sa për ta nisur punimin tuaj?" Kjo më jep njohuri nëse ka nevojë për më shumë udhëzime apo nëse përdoruesi ka informacione të bollshme. Pra, procesi vazhdon dhe unë i bëj pyetjet e njëjta përsëri për të kuptuar nëse përdoruesi i ka kuptuar të gjitha ato që ia kam shpjeguar. Megjithatë, kur të mbaroj me intervistë, gjithmonë ua jap informacionet se si mund të më kontaktojnë po qe se kanë ndonjë pyetje shtesë. Nuk është e mjaftueshme që thjesht ta drejtojmë përdoruesin te burimi më i mirë, i cili i jep përgjigje pyetjes së tij. Por, ne duhet t'i ofrojmë atij një mënyrë me të cilën do të mbesim në kontakt edhe më tutje. Është mjaft lehtë që përdoruesit të dinë të bëjnë kërkimin përderisa janë nën udhëzimet tona, mirëpo nganjëherë ata mund ta humbin fillin e kërkimit kur tentojnë ta bëjnë atë vetë pa praninë tonë. Apo ndoshta e harrojnë ndonjë element të rëndësishëm të cilin ia kemi shpjeguar. Apo edhe se kanë pasur sukses me kërkimin fillestar dhe tani dëshirojnë të kalojnë në kërkime më të përkryera. Pa marrë parasysh se cilat janë nevojat e mëvonshme të tyre, është me rëndësi që t'u ofrojmë një mekanizëm përmes të cilit mund të na kontaktojnë me pyetjet e tyre shtesë.

Shpesh i tregoj përdoruesit, "jam në tavolinën e referencës deri në ora 3, kështu që vizitomë nëse ke ndonjë pyetje tjetër". Përdoruesit kthehen dhe më vizitojnë dhe më bëjnë pyetje shtesë apo më tregojnë se si kanë arritur të bëjnë kërkimin, dhe ky është një informacion i dobishëm në punën time. Unë jam e lumtur kur mësoj se gjërat kanë shkuar mirë, por, po ashtu, shprehi dëshirën që të ndihmoj edhe më tej se si të përdoret një bazë e të dhënave apo ku është vendosur një libër i caktuar, po qe se kanë pasur problem me gjetjen e tyre. Po qe se pyetja e përdoruesit është tepër specifike, apo nëse është në fushën time të specializimit, ua ofroj vizitkartën time dhe i ftoj që të më shkruajnë në adresën time elektronike, apo përmes mesazheve simulant, apo edhe të më bëjnë pyetje shtesë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Studentët gjithmonë duken të kënaqur kur kanë në dorë informacionin tim kontaktues, edhe pse rrallë më kontaktojnë.

Një mënyrë tjetër për të ofruar shërbime të referencës është referenca "shëtitëse". Ky proces mund të gjenerojë një intervistë referale – kjo ndodh kur bibliotekari i afrohet përdoruesit e jo kur përdoruesi vjen në tavolinën e referencës. Referenca shëtitëse është me rëndësi për arsye se përdoruesit mund të kenë druajtje për t'iu afruar bibliotekarit në tavolinën e referencës, me frikën se mund të na ndërpresin në punën tonë; po qe se ne iu afrohemi, kur ata duken të humbur në kërkimin e tyre afër rafteve apo ekranit të kompjuterit, duke hulumtuar katalogun në internet, shpesh janë falënderues për mundësinë për të bërë pyetje në momentin kur ata kanë nevojë. Disa pyetje fillestare në fazën e parë mund të jenë "a po mund të gjeni atë për të cilën keni nevojë?" (kjo pyetje është e përshtatshme për shumë situata!) apo "a mund t'ju ndihmoj për të gjetur diçka?" po qe se thonë "jo, mirë po shkon", do të largohesha. Por, shpesh ndodh që përdoruesit të përgjigjen pozitivisht dhe bëjnë pyetje, që ju shpie në fazën e dytë të udhëzimeve të Shoqatës për Shërbime Referale dhe për Përdorues, që do të thotë të shprehni interesin tuaj në temën e tyre; ju mund të kaloni menjëherë në fazën e tretë dhe të bëni pyetje provuese rreth temës në fjalë. Në fazën e katërt, mund t'i tregoni përdoruesit se si të bëjë kërkimin apo t'i ndihmoni të gjeni materiale në kompjuterin në të cilin është duke punuar ai vetë, e që duket mënyrë më e përshtatshme për ta. Së fundi, në fazën e pestë, jepjani informacionet tuaja kontaktuese kështu që ata të mund të jenë në kontakt me ju po qe se kanë pyetje shtesë. Një element i mirë i referencës shëtitëse është lehtësia për ta përcjellë më tej progresin e përdoruesit: ju mund ta shihni studentin me të cilin keni punuar një orë më herët, është ende i ulur pranë kompjuterit, dhe mund ta pyesni "si po ju shkon? A po mund të gjeni materiale të mira?" Udhëzimet e Shoqatës për Shërbime Referale dhe për Përdorues ofrojnë pyetje të dobishme, të cilat mund t'i bëni pjesë të fjalorit tuaj referal dhe t'i shfrytëzoni atëherë kur keni nevojë.[5]

*/ vijon në numrin e ardhshëm/*

[5] Më pëlqen edhe ky artikull i cili shpjegon në hollësi shumë gjëra sa i përket intervistës referale. I kam përfshirë shumë nga elementet e tij në punimin tim. Ross, Catherine Sheldrick. The Reference Interview: Why It Needs to Be Used in Every (Well, Almost Every) Reference Transaction. Reference & User Services Quarterly. 43, no. 1 (2003): 38-42.

# Problemet e Katalogimit në botim në BKUK

Shqipe Asllani &
Shkëndije Berisha

## TË DHËNAT E KATALOGIMIT NË BOTIM

Katalogimi në botim (Cataloging-in-publication) përmban përshkrimin bibliografik të materialeve. CIP duhet të kenë të gjitha librat që botohen dhe ribotohen.

Ky proces kryhet nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, përkatësisht Sektori i CIP-it, i cili përveç që përshkruan të dhënat bibliografike të njësisë në botim, u jep, gjithashtu informacion botuesve për procedurat dhe ecurinë e kryerjes së CIP-it, si dhe, njëkohësisht, plotëson me të dhëna të reja bazën e vet të të dhënave me botues të rinj: adresa të shtëpive botuese dhe të personave përgjegjës për komunikim.

Që të kryhet CIP-i, botuesi që sjell paraprakisht në bibliotekë librin në dorëshkrim, duhet ta ketë të përfunduar, pra të ketë të gjitha elementet - të dhënat, të renditura sipas rregullave të kulturës së një botimi.

Në procesin e katalogimit në botim, që të vërtetohen të dhënat për materialin, kataloguesi duhet ta kontrollojë dorëshkrimin në tërësi. Vërtetimi i informacioneve parandalon gabimet e mundshme gjatë plotësimit të të dhënave bibliografike.

Sipas rregullave bibliotekare, të dhënat bibliografike merren nga faqja e titullit të librit e jo nga kopertina, prandaj faqja e titullit duhet të përmbajë të dhënat e plota.




*Njësi katalogimi në web-OPAC në programin Aleph*

Kur dorëshkrimit i mungojnë informacione, është i domosdoshëm bashkëpunimi i katologuesit me autorin, përkatësisht botuesin.

Që materiali në dorëshkrim të jetë i saktë me të dhënat që parashihen sipas rregullave të CIP-it, duhet të përmbajë këto informacione:

- titulli/nëntitulli i librit;
- emri i autorit; përkthyesit; përgatitësit; ilustratorit, etj;
- botuesi;
- vendi i botimit;
- viti i botimit;
- vendi dhe emri i shtypshkronjës;
- numri i faqeve;
- formati.

Përveç këtyre të dhënave, përshkrimi bibliografik i materialit në CIP përfshin dhe të dhëna të tjera, nëse materiali i ka, të cilat në gjuhën e kataloguesit quhen *Fusha e vërejtjeve* ose *e shënimeve*. Në këtë fushë hyjnë:

- parathënia;
- pasthënia;
- literatura;
- bibliografia;
- rezymeja etj.

Gjatë procesit të katalogimit në botim, rëndësi të veçantë ka edhe përcaktimi i përmbajtjes së materialit (subjektit), duke u bazuar në Tabelën e Klasifikimit Universal Decimal, që kërkon hulumtim për vendosjen e materialit në lëmin që i përket.

## KOMPLETIMI I SAKTË I TË DHËNAVE TË KATALOGIMIT NË BOTIM

Materiali i dorëzuar për CIP, duhet të jetë i kompletuar - të ketë elemente të domosdoshme për përshkrim. Nëse këto nuk i ka, e vështirësojnë punën e katalogueusit të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Ndodh që dorëshkrimit t'i mungojnë të dhënat e domosdoshme, si: botuesi, vendi i botimit, apo edhe të dhëna të tjera të rëndësishme, si nëntituj jo të plotë, parathënia, pasthënia etj.

Informacioni kryesor për katalogim ndodh të jetë i shpërndarë dhe i paqartë brenda në material. Informacioni në material në këtë formë, shkakton vështirësi dhe shumë dilema gjatë përgatitjes së CIP-it.

Ndonjëherë autori apo botuesi bën ndonjë ndryshim edhe pas marrjes së CIP-it. Nëse autori (botuesi) vendos të ndryshojë ndonjë të dhënë, atëherë duhet ta rikthejë materialin në bibliotekë, që katalogueusi t'i bëjë ndryshimet në CIP. Në të kundërtën, veprimi i tillë i botuesit (autorit) për të ndërhyrë vetë në përshkrimin e të dhënave bibliografike është në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit mbi bibliotekat të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

Ndonjëherë materialin për katalogim e dorëzon punëtori i shtypshkronjës apo dikush tjetër i autorizuar nga autori, botuesi apo shtypshkronja, i cili nuk ka njohuri për materialin e dorëzuar. Kjo situatë e vë në vështirësi katalogueusin, i cili nuk mund të marrë informata të besueshme për CIP nga personi i autorizuar. Prandaj udhëzohet që materiali të dorëzohet nga autori, redaktori ose botuesi.

Dhënia e CIP-it në formë të printuar nga katalogueusi i BKUK-së dhe përshkrimi i serishëm pastaj i të dhënave në material nga botuesi, ndonjëherë ndodh të përshkruhet gabimisht. Për të evituar këto gabime,




*Njësi e Katalogimit në publikim në Alph*

do të duhej që CIP-i të merret në formë elektronike, sepse shpesh, në të tilla raste, në mënyrë të padrejtë i vihet përgjegjësi katalogueusit gabimi që del në CIP, ndërsa ai gabim në fakt është bërë nga botuesi.

Me rastin e marrjes se CIP-it, autorët kërkojnë që këto të dhëna bibliografike t'i marrin menjëherë posa ta dorëzojnë materialin. Kjo e vështirëson punën e katalogimit dhe klasifikimit të materialit, duke pasur parasysh natyrën komplekse të këtij procesi gjatë fazës së përpunimit - deri në kryerjen e plotë të këtij përshkrimi.

Së shpejti pritet që procesi i katalogimit të botimeve të bëhet në programin e automatizuar Aleph 500, që do të lehtësojë një seri procesesh që kryhen gjatë përshkrimit bibliografik - mbi bazën e shkëmbimit të informacionit, përkatësisht bazës së të dhënave, si dhe të listave standarde – Treguesi i Emërtime Lëndore për zgjedhjen e subjekteve që trajtohen në një vepër.

## PLOTËSIMI I TË DHËNAVE PËR NJËSI AUTORIALE (AUTHORITY RECORD)

Meqenëse tani në BKUK punohet me programin e automatizuar Aleph 500, në kuadër të programit është duke u krijuar edhe një bazë e të dhënave të emrave dhe emërtimeve të standardizuara - Njësi Autoriale (Authority Record) për të gjithë autorët shqiptarë dhe të huaj.

Me këtë, parashihet të plotësohen gjatë procesit të Katalogimit në botim, të dhënat për autorin, i cili ka dy apo më shumë identitete bibliografike, duke përshkruar emrin/mbiemrin e tij në të gjitha format: në origjinal, në gjuhët e tjera, pseudonimin e tij, titullin e nderit, titullin shkencor, viti i lindjes, iniciale ose forma të tjera - forma këto që bëhen referime për të njëjtin autor gjatë kërkimit *për autorin.*

Në mungesë të informacionit të kompletuar nga burime elektronike apo katalogë manualë për 'emrat' e një autori, autori i librit apo botuesi do të na ndihmojë kur do të sjellë në bibliotekë, me rastin e dorëzimit të materialit në dorëshkrim, të gjithë emrat me të cilët njihet i njëjti autor.

Nëpërmjet këtij përshkrimi për Njësi Autoriale, do të ndihmohet në hulumtime dhe hartim të bibliografive, plotësim të katalogëve, si dhe në kërkime më të plota për autorë, përkatësisht vepra nga përdoruesit dhe hulumtuesit shkencorë në katalogun elektronik të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

Sektori i CIP-it është duke përgatitur një manual për botuesit, që do të japë informacione bazë për rëndësinë që ka Njësia Autoriale, me shpresë se do të ndihmojë për kompletimin e të dhënave për autorë.

# Mbi historinë e shkrimit në materiale të buta

Edhe pse shkruhej në materiale të ndryshme, paleografia me kalimin e shekujve e ka ngushtuar rrethin e studimeve të veta të materialeve të shkrimit në ato të buta ose gjysmë të buta, siç janë: dylli, papirusi, pergamena dhe letra. Njohja me llojet e materialeve të buta, mbi të cilat është shkruar dhe me të cilat është shkruar, ka një rëndësi të veçantë sidomos për bibliotekarët dhe arkivistët, të cilët edhe ndeshën me këto materiale gjatë punës së tyre të përditshme.

Materialet e forta (*guri, mermeri, tullat-argjile*), bien në kuadrin e studimit të arkeologjisë, epigrafisë dhe numizmatikës.

Nëse dëshirojmë që një shkrim t'ia nënshtrojmë tërësisht kritikës, gjithsesi duhet t'i japim rëndësi dhe materialit ku është ruajtur ai shkrim.

Njeriu, për të shkruar, ka përdorur të gjitha materialet në të cilat ka qenë e mundur të shkruhet. Materiali i shkrimit natyrisht se ka ndikuar në formësimin e shkronjave sikurse edhe mjetet për shkrim që kanë ndikuar në shpejtësinë e shkrimit, si dhe në formën e shkronjave. Në radhë të parë prej kohëve më të vjetra, si material shkrimi janë përdorur pllakat e argjilat, sidomos në Babiloni dhe Asiri. Në përdorim të përditshëm, grekët kanë përdorur të ashtuquajturat *ostrokone* për votim. Gjithashtu, edhe guri është përdorur për të shkruar te të gjithë popujt e lashtë. Mbishkrimet mbi gurë kishin për qëllim që një shkrim të ruhet për një kohë të gjatë.

Edhe metali është përdorur për të shkruar. Nga monumentet metalike duhet veçuar diplomat ushtarake apo privilegjet e veteranëve ushtarakë. Tërë hapësira e Perandorisë Romake kishte diploma të tilla, pra edhe treva jonë, e cila një kohë ishte nën sundimin e Perandorisë Romake kishte materiale të tilla. Druri, argjendi dhe plumbi gjithashtu gjatë antikitetit dhe mesjetës janë përdorur si materiale shkrimi. Plumbi është përdorur për të ashtuquajturat **Tabela Mallkimi** ose për vula. Kurse, druri si material shkrimi dhe i lirë është përdorur gjithashtu si material shumë i përshtatshëm për shkrim, i cili është përdorur edhe gjatë antikitetit dhe mesjetës. Më së shumti druri është përdorur në shkollë me rastin e ushtrimeve për të shkruar. Gjatë mesjetës edhe kalendarët janë shkruar në dru.

Plini Plak në verën e vetë *Historia e natyrës* thotë se në të kaluarën është shkruar në fletën e **palmës** si dhe në fletën e bimëve të tjera. Indusët e vjetër kanë shkruar në fletët e një lloj palme me fletë të gjëra. Për të shkruar në palmë, është përdorur **gjilpëra metalike**. Me fletët e palmës të lidhura është bërë edhe libri i vërtetë.

Si material shkrimi është përdorur edhe **lëkura e kaut dhe e cjapit**, sidomos te persianët, hebrenjtë dhe grekët. Ndërkaq pëlhura si material shkrimi nuk ka mundur të qëndrojë gjatë dhe rrallë është përdorur për shkrim. Pëlhura më tepër është përdorur në Egjipt dhe tek etruskët për të pështjellë mumiet, kurse në shiritin e pëlhurës janë shkruar tekste të ndryshme ritualesh.

Në kufirin mes arkeologjisë e paleografisë, gjenden **tabelat prej dylli**. Përdorimi i tabelave të dyllit i takon një të kaluare të largët. Këto janë tabela të vogla kënddrejte të



thelluara me një cep më të ngritur në të katër anët. Në atë thellim derdhej dylli i ngjyrosur ose i pangjyrë dhe rrafshohej sipërfaqja e tabelës së dyllit dhe atëherë mbi të mund të shkruhej me ndonjë objekt të fortë dhe të mbrehtë prej metali, druri apo ashti të elefantit. Për këtë arsye termi ***scribere*** d.m.th. grithje me metal të mprehur ose pikturim.

Tabelat e dyllëzuara në gjuhën greke quheshin **Pinac**, ndërsa në latinisht **tabule, tabele** etj. Pllakëzat e dyllit lidheshin mes vete me spagë nga dy e më tepër sosh dhe quheshin **Kodexe**. Kështu, dy pllaka të lidhura quheshin ***diptih*** (duplices), tri pllakëza ***triptih*** (triplikes), pesë pllakëza ***pentaptih***, ndërsa kur ishin më shumë sosh quheshin ***poliptih*** (multiplices). Mjeti që është përdorur për të shkruar mbi këto pëllakëza është quajtur **stilus**. Stilusi rëndom ishte prej metali, druri ose ashti dhe i mprehtë .

Pas dyllit, si material shkrimi vjen papirusi, atdheu i të cilit konsiderohet Egjipti. Papirusi është një term për të cilin ende nuk kemi një kuptim të saktë. Ka të ngjarë se fjala papirus ka kuptimin e një bime të Nilit, të cilën Herodoti e quan **biblos**. Leximi i tekstit në papirus është shumë më i lehtë dhe më i qartë se sa në tabelat e dyllëzuara, sepse mjeti për të shkruar – **kallamusi** në papirus ka lënë gjurmë më të qarta të ngjyrës, ndërsa **stilusi** ka lënë vetëm gjurmët. Me përpunimin e papirusit fillon edhe historia e librit. Papirusi u paraqit në rajonin moçalik të Nilit, përkatësisht në rrjedhën e poshtme të tij. Derisa lulja e papirusit përdorej për stoli; prej palcës së tij është punuar materia për shkrim, siç na njofton lidhur me këtë Plini në veprën e tij "*Historia e natyrës*".

Kështu, shiritat e prerë të palcës së papirusit të radhitura sipas gjatësisë, quheshin **skeda**, mbi këto hidhej shtresa e re e lyer e shiritave të ndarë, e cila quhej **silis ose plagula**. Disa plagula të tilla përbënin scapusin ose **tabakun**, ndërsa tabaku i përgatitur për shkrim quhej *hartes* ose **charta**. Tabaku i lakuar quhej **kokorreth - rotulus** (rrotullues). Rrotullueset e tilla zakonisht vendoseshin në sarkofagë ose kuti të rrumbullakëta të quajtura cista. Për të shkruar në papirus është përdorur fytëza e kallamit moçalik me maje të mprehtë që është quajtur **kallames;** për shkrim është përdorur ngjyra e përgatitur nga rrëshira e përzier me ujë, e cila është quajtur **grafikon**, kurse në gjuhën shqipe **ngjyrë e zezë**.

Gjatë mesjetës në shkrim përdorej ngjyra e kuqe, e verdhë dhe e gjelbër. Qendra kryesore ku është bërë shitblerja e papirusit është Aleksandria. Në Egjipt, papirusi u prodhua pa ndërprerje deri në shek. XI, atëherë kur hyri në përdorim pergamena dhe letra.

Një material shumë i përhapur ka qenë, edhe **pergamena**, për të cilën është vështirë të konstatohet se kur ka filluar të përdoret pergamena. Sipas Plinit thuhet se mbreti Egjiptas Ptolemeu II, duke qenë i ngazëllyer për pasuritë e bibliotekës së Aleksandrisë dhe duke ruajtur epërsinë e saj ndaj bibliotekave të tjera, ka penguar eksportimin papirusit prej Egjiptit në Pergam ku sundonte mbreti Emens II (195-158 p.l.K), i cili përgatitej ta themelonte një bibliotekë, e cila do të ishte më e pasur se ajo e Ptolemeut në Aleksandri. Me këtë rast në Pergamon, qendrën e shtetit Pergam, ka filluar prodhimi i lëkurës për shkrim e quajtur **pergamena** sipas qytetit në fjalë. Shumëkush dyshon në këtë tregim të Plinit; e gjithë ajo që thuhet te Plini, ka të ngjarë se është e vërtetë vetëm emri i qytetit ku është prodhuar pergamena.



Herodoti flet se Jonasit kanë shkruar në pergamenë, të cilës ia kanë dhënë emrin “**diftherra**”, nga kjo del edhe fjala turke “**tefter**”. Të gjithë shkrimtarët klasikë pergamenën e kanë quajtur **membrana**. Këto terme gjatë mesjetës i hasim edhe në trajtën: *karta, kartamembrana, kartapergamena* etj. Pergamena është quajtur edhe sipas lëkurës së kafshës, p.sh. **charta vina** (dashit), caprina (dhisë), vitulina (viçit). Pergamena e hollë dhe më cilësore prodhohej prej lëkurës së vjetave të porsalindur ose të pa lindur (**charta virginea**). Në pergamenë, në fillim për të shkruar u përdor fytëza e kallamit , kurse më vonë me **pupël shpendi** (*talamus et pena*). Pergamena kishte përparësi të madhe në krahasim me papirusin

Nga materialet e fundit të shkrimit, për të cilën do të bëjmë fjalë - është **letra**, e cila ka origjinën nga Lindja dhe këtë e shpikën kinezët, të cilët ua besuan arabëve këtë fshehtësi kah fillimi i shek. VIII.

Gjatë zhvillimit të vetë, letra ka kaluar nëpër 3 faza: 1. Faza kineze, 2. Faza arabe, Faza moderne.

***Faza kineze.*** Kinezët për një kohë të gjatë përdorën si material shkrimi pëlhurën e mëndafshit. Është e natyrshme se sasia e mëndafshit nuk mjaftonte për të shkruar në një popullatë të madhe sikur që ishin kinezët. Për këtë arsye, ky material shkrimi ishte i shtrenjtë për përdorim të përditshëm. Kinezët kanë përdorur edhe pllakëzat e bambusit, (Bambuja) të cilat ishin të rënda dhe të papërshtatshme. Në këtë situatë një dijetar i shquar kinez që udhëhiqte fabrikën perandorake armëve, në vitin 105, prodhoi letrën prej mbështjellësve të mëndafshit (Tsai Lun).

Më vonë mbështjellësve të mëndafshit, si lëndë e parë për prodhimin e letrës, i shtoheshin edhe kallami i bambusit, lëvoret e drurit, pëlhurat e vjetra dhe leckat e rrjetave të peshkatarëve. Me një fjalë, për prodhimin e letrës është përdorur një lëndë që nuk ka hyrë në përdorim fare. Kinezët, në shekujt e ardhshëm e përsosën teknologjinë e prodhimit të letrës, duke i shtuar edhe lëndë të reja, si: kashtën e orizit si dhe lëvoren e manës (dudi). Për një kohë të gjatë, kinezët e ruajtën me xhelozi fshehtësinë e prodhimit të letrës. Së pari letra arriti në Kore, kurse përmes këtij vendi, rreth vitit 610 ose 700, letrën mësuan ta prodhonin edhe japonezët.

Letra më e vjetër është gjetur në Turkistan të Kinës dhe mban datën rreth viti 900 të erës sonë.

***Faza arabe.*** Kinezët në pjesët kufitare të veta në vitin 571 luftuan me arabët. Arabët jo vetëm që ia arritën t’i dëbojnë kinezët, por ndërmorën edhe kundërofensivë, duke pushtuar qytetin Samarkad (Uzbekistan). Në këtë mënyre, arabët prej disa skllevërve të luftës mësuan për sekretin e prodhimit të letrës. Që në vitin 751 në Samarkand, arabët inauguruan punëtorinë e prodhimit të letrës, pastaj një punëtori tjetër në Bagdat në vitin 794, pastaj në Damask.

Që në vitin 1052, gjejmë në Bizant një dokument të shkruar në letër. Me ekspansionet ushtarake e politike të arabëve në trevat spanjolle në shek. XII, në një qytezë afër Valencës u prodhua letra - për herë të parë në Evropë. Në Itali, letra është prodhuar për herë të parë në shek. XIII, sidomos në qytetin Fabriano në afërsi të Peruxhas. Në Gjermani, dokumenti më i vjetër rrjedhë që nga viti 1248, mirëpo punëtoritë e para i kemi në Kehln dhe Majnë. Edhe në Shqipëri gjejmë dokumente të shkruar në letër në shek. XIII, mirëpo për fabrika nuk dimë asgjë.

Studiusi zviceran Sh. Brike, në një vepër të tij, thekson se arabët njihnin madhësi të letrës, duke filluar nga letra me madhësi që është përdorur për postë e deri të madhësia më e madhe. Ky studiues zbuloi një mbishkrim me një pallat të Bolonjës që daton nga shek. XIV-XV, ku bëhet fjalë edhe për ekzistimin e 4 madhësive të letrës: 1. Karta Imperiale, 2. Karta Reale, 3. Karta Meçana, 4. Karta Reçuta.

***Faza moderne e prodhimit të letrës.*** Fizicenti dhe biologu i njohur francez Rene Antoine Ferchault de Reaumur (1683-1757) njoftoi opinionin që në vitin 1719, se përmes pluhurit të drurit të kalbur mund të prodhohet një materie e ngjashme me letrën. I pari, i cili arriti të prodhojë këtë, ishte një prift i Regenzburgut (Jakob Kristian Schafferu 1718-1790). Prej kësaj kohe druri është bërë lëndë kryesore për prodhimin e letrës.

Çështjen se si duhej të imtësohej (bluhej) druri dhe të përgatitej lënda për lerën e zgjodhi Fridrih Keler në gjysmën e dytë të shek. XIX. Duhet theksuar se prodhuesit evropian sollën një risi në prodhimin e letrës për të cilën nuk dinin as kinezët e as arabët, është fjala për *filigranologjinë* ose shenjat e ujit.

*Literatura:*

B. Bischoff, ***Latin Palaeography: Antiquity and the Middle Ages***, Cambridge University Press, 1990.

V. Novak, ***Latinska paleografija***, Beograd 1952.

J. Stipiši , ***Pomo ne povijesne zananosti u teoriji i praksi***, Zagreb 1985.

Përgatiti: Gjon Berisha

# Terminologjia bibliotekare në bibliotekat shqiptare



MR. TAHIR FONIQI

Terminologjia bibliotekare në Shqipëri, Kosovë e në trevat e banuara me shqiptarë, vazhdon të ecën me një mori shmangiesh, mospërputhjesh e mospajtimesh, duke u bërë, kështu, njëra nga çështjet më kryesore dhe më të rëndësishme në një diskutim të ardhshëm. Që të kapërcehen dallimet dhe të evidentohen ngjashmëritë - burimet e përbashkëta të pikëpamjeve, rruga e përmbushjes së kësaj detyre është diskutimi për shumën e saktë të perceptimeve dhe formulimeve terminologjike - rrëshqitjeve, duke përdorur në përvojat tona bibliotekare - herë një fjalë, herë një fjalë tjetër, herë një rregull, herë një rregull tjetër. Është një punë që do të duhej të jetë jo e nxitur, e kujdesshme, e saktë e bibliotekarëve, gjuhëtarëve, përkthyesve, botuesve, kërkuesve, për të nxjerrë një pasqyrë reflektuese për semantikën e fjalëve dhe të termave - një vijë ndarëse të qartë për regjistrin e të gjitha shprehjeve që do të jenë mes marrëveshjeve dhe harmonizimit të standardeve që do të hartoheshin për një terminologji unike.

Sot e gjithë ditën në media, aktet normative të bibliotekave, Ligji për bibliotekat, në bisedat e përditshme, dëgjohen e përdoren terma e konstrukte bibliotekare të paqëndrueshme e të diskutueshme, si: "bibliotekë masive", "bibliotekë e qytetit", "bibliotekë vetjake", "bibliotekat provinciale", "bibliotekat akademike", "bibliotekat e veçanta", "faqja titullare", "fondi i vendlindjes", "bibliotekat shqiptare", "bibliotekonomi", "bibliotekaria kosovare", "përpilimi i bibliografisë", , "krijimi i regjistrave", "përpunimi analitik i revistave", "krijimi i regjistrave", "bibliografi kryesore", "bibliotekistët", "katalog përmbledhës", "organizimi i bibliografisë…" etj.

P.sh. lexojmë shpesh për termin *bibliotekonomi,* si: "... biblioteka do të marrë pjesë me botime bibliografike dhe të bibliotekonomisë"; "... bibliografia si veprimtari intelektuale dhe si pjesë e bibliotekonomisë…"; "Bazat e bibliotekonomisë është një udhëzues teorik e praktik në ndihmë të punonjësve të këtyre bibliotekave…".

Mendoj se termi "bibliotekari" është më përmbajtjesor, e shpreh më bindshëm karakterin kulturor e "shpirtëror" të veprimtarisë së bibliotekave. Njëherësh, ky term ka strukturë fjalëformuese shqipe: bibliotekë + a + ri + a = bibliotekaria. Citoj: "Bibliotekaria është përmbledhje e disiplinave shkencore, e cila merret me librin e përdoruesit e saj, përkatësisht me çështje teorike e praktike bibliotekare. Përfshin historinë e librit e të shtypshkronjave, historinë, organizimin dhe administrimin e bibliotekave, bibliografinë, psikologjinë e përdoruesve, sociologjinë e të lexuarit etj.".

Me gjasë termi "bibliotekonomi" (me burim nga greqishtja), në përdorimin tonë, ka hyrë nga gjuha frënge: "bibliotheconomique" apo rusishtja: "bibliotekovedenie", ndërkohë që ky term nuk gjendet në fjalorin: latinisht, italisht, anglisht, gjermanisht etj.

Për më tepër ka filluar edhe "copëzimi" e "krahinorizmi" i termave bibliotekare. Lexojmë: "çfarë kuadri ka bibliotekaria e Kosovës?", "për bibliotekarinë kosovare", "bibliotekaria në komunën NN, "fondi kosovar" etj. Ta marrin në shqyrtim shprehjen: "fondi kosovar". Ky nocion, në themel, redukton atë që njihet frymë e kulturës kombëtare, duke hyrë në përshtatje me instrumentet përkatëse politike që i prodhon konteksti i organizatave dhe forumeve politike për nevoja që bien ndesh me identitetin etnik kulturor.

Më poshtë po japim një listë fjalësh e termash që shprehin një mori shmangiesh në terminologji mes Shqipërisë dhe Kosovës, si:

Bibliotekë e Bashkisë = Bibliotekë komunale; Përg. për bot. = Përgatiti për botim; Tir. = Tirazhi; Shkrimi në Braj = Shkrimi Braille; Regjistri i emrave gjeografikë = Regjistri i emrave të vendeve; Skeda shtesë = Skeda udhëzuese; Kopja e detyruar = Ekzemplari i obliguar; Fusha e përshkrimit fizik të skedës = Fusha e përshkrimit skedarik; Vija e pjerrët = Shenja e autorit; Bot 2 = Botimi 2; Me il. = ilustr.; Sektori = Seksioni; + = &; Bibliotekat e veçanta = Bibliotekat speciale; Llojet e bibliotekave = Tipat e bibliotekave; KDU (Klasifikimi Dhjetor Universal) = KUD (Klasifikimi Universal Decimal) etj.

Gjuha shqipe ka marrë terma e konstrukte bibliotekare nga gjuhët e huaja: greqishtja, gjuha angleze, gjuha frënge, gjuha ruse etj., si: "sine anno", "sine loco", "sine nomine", "paginim", "autonim", "koautor", "almanah", "aneks", "ekzemplar", "afishe", "informatë", "anketë", "volum", "anonim", "inventarizim", "poliglot", "Kurent" etj., ani që këto terma mund të zëvendësohem me terma e shprehje të gjuhës shqipe: "pa vit të botimit", "pa vend të botimit", "pa botues", "faqosje", "emri i saktë i autorit", "bashkautor", "vjetar", "shtojcë", ""kopje", "shpallje", "vëllim", "regjistrim", "shumëgjuhësh", "lloj letre në dorëshkrim", gjithnjë duke e pasur për bazë mendimin e Eqrem Çabejit: "Një ndër detyrat kryesore të gjuhësisë shqiptare, krahas kërkimeve teorike, është edhe mbetet pasurimi i gjuhës me elemente të gurrave vetjake dhe spastrimi i saj prej masës së fjalëve të huaja, që kanë vërshuar së jashtmi dhe që po vërshojnë edhe në ditët tona".

Rrjedhimisht është e nevojshme, që të formohet një trupë, me qëllim të shqyrtimit e të harmonizimit të termave e mospërputhjeve bibliotekare. Të ndiqet parimi: një gjuhë, një sistem bibliotekar!

# Lessing: *Tregimi i dikton mënyrat e rrëfimit të tij*

*(Intervistë telefonike me shkrimtaren, Doris Lessing, bërë nga Adam Smith, kryeredaktor i uebfaqes Nobelprize.org, pas shpalljes së saj fituese e Çmimit Nobel për Letërsi, më 11 tetor 2007)*

***Doris Lessing** (lindur si **Doris May Tayler** në Kermanshah, Iran, më 22 tetor 1919) është shkrimtare britaneze, autore e veprave si Bari po këndon dhe Fletorja e artë e shumë e shumë të tjera. Në këtë vit, Lessing e fitoi Çmimin Nobel për Letërsi, duke e ngritur në njëmbëdhjetë numrin e grave që e fitojnë këtë çmim në historinë 106-vjeçare të këtij çmimi, e gjithashtu duke u shenjuar si personi më i vjetër që e merr këtë shpërblim. Lessing ishte arsimuar në Shkollën e Lartë të Konventës Domenikane në Salizburi (tash Harare). Ajo e la shkollën në moshën 13-vjeçare, ku më pastaj bëri mësime në formë autodidakte. La shtëpinë në moshën 15-vjeçare dhe filloi të punonte si infermiere, në kohën kur edhe filloi leximin e materialeve nga politika dhe sociologjia. Ajo filloi të shkruante në këtë kohë. Në vitin 1937, Lessing filloi punën si operatore telefonike, kohë kjo kur edhe u martua me burrin e saj të parë, Frank Uisdom, me të cilin pati dy fëmijë, para se martesa e tyre të përfundonte në vitin 1943. Pas kësaj ndarjeje, Lessing iu bashkua Klubit të Librit të Majtë, që ishte një klub i librit komunist, ku edhe u takua me burrin e saj të dytë, Gotfrid Lessingun. Ata ishin martuar posa kjo i ishte bashkëngjitur këtij grupi dhe kishin pasur së bashku një fëmijë, para se edhe kjo martesë të përfundonte me ndarje në vitin 1949. Godfrid Lessingu, më vonë, u bë ambasador i Gjermanisë Lindore në Ugandë, ku edhe ishte vrarë në rebelimin e vitit 1979 kundër Idi Amin Dadas. Menjëherë pas shpalljes fituese të Nobelit, Lessing u tha gazetarëve para shtëpisë së saj: "I kam fituar të gjitha shpërblimet në Evropë dhe për këtë jam shumë e kënaqur". Ajo që duhet të thuhet me këtë rast është se fiksioni që e shkruan Lessingu mund të ndahet në tri faza të dallueshme: Tema komuniste (1944-1956), kur ajo shkruante në mënyrë radikale për çështjet sociale, pastaj Tema psikologjike (1956-1969) dhe pas kësaj Tema sufi, e cila është eksploruar në serinë e shkrimeve fantastiko-shkencore të saj. Kur e pyesin se cilin libër do ta veçonte nga librat e tjerë të shkruar nga dora e saj, ajo e zgjedh serinë e rrëfimeve fantastike Kanopusi në Argos ku hasen konceptet sufi, të cilat dalin edhe te veprat e tjera të saj.*



*Doris Lessing*

Doris Lessing: Alo.

A. Smith: *Mirëmëngjesi, ju lutem a mund të flas me Doris Lessingun?*

Doris Lessing: Me kë po bisedoj?

A. Smith: *Jam Adam Smithi nga uebfaqja e Fondacionit të Nobelit. E kemi traditë që të marrim intervista shumë të shkurtra telefonike me Laureatët e rinj për arkivin tonë, dhe kam shpresë se mund të flasim me ju për disa minuta?*

Doris Lessing: Mirë, atëherë le të vazhdojmë.

A. Smith: *Ju faleminderit shumë. Natyrisht, urime.*

Doris Lessing: Faleminderit.

A. Smith: *Dyshoj se keni pasur mundësinë të shihni citatin nga Akademia Suedeze?*

Doris Lessing: Jo, realisht jo, nuk e kamë parë atë. Ju e dini, në mesditë isha duke u kthyer nga spitali ku e mora djalin tim. Nuk kam parë asgjë të shkruar apo diçka tjetër… Por kam folur me njeriun që e drejton Komitetin e Nobelit.

A. Smith: *Pra keni folur me Horac Engdahlin?*

Doris Lessing: Po.

A. Smith: *Ata ju përshkruajnë juve, në citation e tyre, si "epiciste e përvojës femërore, e cila me anë të skepticizmit, zjarrit dhe fuqisë vizionare e ka sjellë në shqyrtim hetues civilizimin e ndarë". A mendoni se kjo i afrohet deri-diku hetimit të misionit nëpërmjet së cilit ju shkruani?*

Doris Lessing: Unë nuk e di realisht se çka ata kanë pasur në mendje kur e kanë shkruar këtë dhe këtë ju e shihni. Mendoj se ata janë përballur me një numër të mahnitshëm dhe me kufij të shumtë të shkrimit. T'i përmbledhësh në një fjali të gjitha këto do të ishte një punë shumë e *vështirë*. A po mendoni edhe ju kështu?

A. Smith: *Po në të vërtetë.*

Doris Lessing: Nuk është edhe aq e lehtë.

A. Smith: *Mirë atëherë, kemi mbi pesëdhjetë libra dhe një kombinim të stileve të shkrimit që në njëfarë mënyre e sfidojnë përshkrimin. Pra shumë. A mendoni në vetvete se më shumë keni mision kur shkruani, sesa të rrëfeni tregime?*

Doris Lessing: Absolutisht jo. Jo, sepse mos e harroni një gjë se unë kam qenë dikur komuniste dhe ne kemi pasur shumë, shumë shembuj të këqij

të shkrimtarit inxhinier i shpirtit njerëzor. Kjo mjafton që çdonjërin nga ne të na bëjë të trembemi. Ju e dini, unë isha e kësaj gjenerate.

A. Smith: *Pra ju ia lini lexuesit të vendosë se çfarë misioni do të gjejë në shkrimin tënd?*

Doris Lessing: Po ju e dini se lexuesi këtë e bën në çdo mënyrë. Lexuesi apo lexuesja ia mbush vetvetes mendjen dhe me këtë rast shkrimtari ecën së bashku me të. Këtu nuk mund të bëni asgjë, realisht, edhe nëse e marrin absolutisht gabimisht ndonjë pjesë të cilën e keni shkruar, prapë nuk mund të bëni asgjë. Nuk do të mund të bëni ndonjë lloj deklarate e të thoni: O i dashur lexues, kjo nuk është aspak e saktë. Ajo që kam dashur të them unë është diçka tjetër". Jo, jo, ju shkruani, dhe pastaj ata (lexuesit) bëjnë çfarëdo që duan nga ajo.

A. Smith: *Kështu që, ata që... sipas përvojave të mëparshme shpërblimi me Çmimin Nobel do të inkurajojë miliona që të mbërrijnë deri te shkrimet tuaja, te të cilat nuk kanë qenë më parë. Për ata që nuk kanë sprovuar shkrimin tuaj, a do të mund të sugjeronit ndonjë vend për pikënisje?*

Doris Lessing: Po, do t'u sugjeroj diçka që mund edhe t'u befasoj juve, vetëm për faktin se të rinjtë e duan atë. Kjo është *Fëmija i pestë*. Për befasinë time kam hetuar se këtë e duan shumë adoleshentët. Prandaj, mund të fillojnë me këtë dhe të shohin se si kanë bërë ata. Gjithashtu, e kam shkruar një tregim aventuristik që titullohet *Mara dhe Deni*, të cilin e di që e duan të rinjtë, lidhur me… paskëtaj edhe romanin tim të parë, *Bari po këndon*, i cili ende është shumë i gjallë. Mund të përpiqen në këto shkrime.

A. Smith: *Produktiviteti juaj natyrisht se është fenomenal dhe më këtë rast supozoj se disa njerëz mund të hamenden lidhur me atë se si arrini ju të prodhoni kaq shumë letërsi. A mund të mendohet se ju keni një tendencë të pandalshme të punës? A keni tashmë shumë rrëfime për të treguar? Çka i shtyn këto rrëfime në udhën e tyre?*

Doris Lessing: Mirë, është sigurisht e saktë se kjo shtytje ekziston, më shtyn vetvetja sa i përket të shkruarit. Por ju e dini se unë s'bëj asgjë tjetër. Nuk kam edhe shumë jetë sociale dhe kamë qenë e mbërthyer nga rrethanat e tjera në jetën time, të cilat më kanë mbajtur në gjendje që të shkruaj. Ju e dini, nëse nuk do ta bëja një gjë të tillë (natyrshëm jam person social) mendoj se do t'ia prishja jetës sime që të ketë kënaqësi, me të cilën i kam punët mirë.

A. Smith: *Pra, a është ky një azil i vetimponuar, apo është se shkrimi gjithnjë e ka prezantuar vetveten si një mundësi më e mirë?*

Doris Lessing: Kjo është ajo që e bej unë. Gjithnjë shikoj se çka kam shkruar. Gjithnjë, zakonisht mendoj edhe për atë se çka jam duke shkruar. Por, ju edhe e dini se nuk kam ndonjë rreth të gjerë të interesimeve të tjera, le ta lëmë këtë punë kështu. Për një apo arsye tjetër.

A. Smith: *Por, kur sheh njeriu transmetimin televiziv të reagimit tuaj ndaj lajmit të djeshëm, dikush mund ta hamendësojë përgjigjen ndaj kësaj pyetjeje, por përveç kësaj si e shihni valën e mundshme të kujdesit të shtuar që çmimi e dikton në fokusimin tuaj, për t'iu marrë, pyetur juve?*

Doris Lessing: Oh, nuk mendoj… ju e dini, njerëzit do ta humbin krejt interesimin brenda një apo dy muajve. Ata nuk mund ta kalojnë tërë kohën e tyre duke kërkuar intervista. Dhe, përveç kësaj, as unë nuk kam kohë. Nuk kam kohë për të gjithë. Prandaj vetvetiu problemi do të zgjidhet.

A. Smith: *Një çështje për të cilën dëshiroja t'u pyesja lidhet me shumësinë e stileve që i shkruani. Ju keni prekur gjithkund, përveç ndoshta poezisë. A është kjo një zgjidhje e vetëdijshme të përpiqesh ta zgjerosh repertorin tuaj, apo këto janë vetëm forma të cilat duhet të përdorën që ju të arrini ta shprehni vetveten?*

Doris Lessing: Jo, që në momentin kur e kam idenë, tregimi, ose diçka tjetër, që është në mendjen time, duhet ta gjejë shprehjen e drejtë. Ju e dini, unë nuk them "Oh, tash do ta shkruaj, nuk e di çka, por ta zëmë një libër realist prej 50.000 fjalësh". Ajo çka ndodh është se libri, tregimi dikton se si unë do ta realizojë atë. Tregimi i dikton mënyrat e rrëfimit të tij. Prandaj kam shkruar në shumë stile të ndryshme, nëse doni të thoni kështu, sepse unë kam shkruar shumë tregime të ndryshme. Nuk është këtu në pyetje dëshira për t'u përpjekur në këtë apo në atë mënyrë. Mendoj se kur kisha filluar t'i shkruaj seritë e Shikastres, e cila në vetvete mbulon miliona vjet, ky fakt në brendësinë e tij e dikton edhe stilin. Ju nuk mund ta filloni shkrimin e tillë duke thënë, "Oh shumë bukur, Xho Blogu është ulur në kuzhinën e tij dhe ka pirë një çaj të Typos dhe i ka shkruar një letër kunatës së tij". Ju duhet të gjeni një rrugë tjetër për ta bërë një gjë të tillë. Kjo është ajo që ndodh lidhur me këtë çështje.

A. Smith: *Po. Kjo ndoshta edhe i ka ndihmuar kohëzgjatjes që Akademia Suedeze të marrë vendim për t'ju nderuar juve me Çmimin Nobel përderisa ju keni përfshirë stile që ndoshta mund të cilësohen si jo-tradicionale.*

Doris Lessing: Mendoj se, ndoshta, njerëzit e Nobelit nuk e duan atë që e quajnë "fantastiko-shkencore". Mendoj se kjo është një etiketë shumë e gabuar të cilën e përdorin, por ndoshta ata kanë dalë pikërisht nga kjo kur kanë parë *Memoaret e Mbijetuesit* për shembull, apo *Fjalimi për kalimin në ferr*. Këto janë shumë të lehta për t'i kategorizuar. Por ndoshta për ta ka qenë e vështirë.

A. Smith: *Por mirë, duket se ka pasur shumë njerëz të cilët e kanë pritur të çliruar këtë zgjidhje. Ka pasur një brohoritje e gëzim të madh kur Horac Engdahli e shpalli dje emrin tuaj.*

Doris Lessing: Faleminderit, faleminderit, faleminderit.

A. Smith: *Atëherë ju faleminderit shumë që folët për ne dhe kur të vini në dhjetor në Stokholm, për ta marrë shpërblimin, mendoj se Horac Engdahli do të zhvillojë një intervistë më të gjerë me juve. Pra presim që të takohemi prapë.*

Doris Lessing: Atëherë mirupafshim. S'ka problem, faleminderit.

A. Smith: *Ju faleminderit shumë.*

Doris Lessing: Mirupafshim.

A. Smith: *Mirupafshim, mirupafshim.*

# Projekti i OSBE-së për përmirësimin e cilësisë në BKUK

*Prishtinë, 8 tetor 2007*

Projekti i OSBE-së i Departamentit për Qeverisje të Mirë dhe Institucione Demokratike – Njësia për Arsimim të Lartë, përfshin investim në infrastrukturë dhe ndihmë profesionale për stafin e BKUK nëpërmjet trajnimeve. Ky projekt është duke e ndihmuar BKUK-në në përmirësimi i cilësisë dhe në rezultate të qëndrueshme në fushat, si: menaxhim më të mirë dhe përmirësim të procesit të rrjedhës së punës; lehtësim dhe mirëmbajtje të praktikave më të mira, inkurajim dhe zhvillim të mëtutjeshëm të stafit, si dhe të rritje të cilësisë së përgjithshme të shërbimeve në të mirë të përdoruesve akademikë.

Në kuadër të kësaj ndihme, është bërë abonimi në Sistemin menaxhues për qasje në Athens dhe në koleksionet e Oxfordit, si dhe vlerësim i brendshëm për aranzhim të resurseve fizike dhe digjitale të bibliotekës.

Projekti tashmë është duke organizuar një trajnim pesëditorë për konfigurim dhe manipulim me programin Aleph 500 në modulet e Pasurimit dhe të Qarkullimit. Gjithashtu - një kurs se si të përdoret sistemi menaxhues për qasje në Athens; se si të përdoret sistemi menaxhues për rezervim të Kompjuterëve PC të softuerit Envisionware, si dhe kurs për modulet operacionale të Sistemit administrativ dhe Sistemit librar të Aleph 500.

osce
Mission in Kosovo

Nëpërmjet këtij projekti, BKUK pajiset me 7 kompjuterë për shfrytëzim nga studentët e magjistruar dhe ata që ndjekin doktoraturën; një printer i formatit A3 dhe A4, së bashku me opsionet për skanim, fax, dhe rrjetë; një aparat TV me ekran të madh për shfaqje të programeve të ndryshme, një projektor LCD për nevoja të ndryshme, si dhe një DVD me sistem sorround për nevoja zërimi.

## U organizua takim me botuesit më të mëdhenj të Kosovës

*Prishtinë, 28 shtator 2007*

Zyra e ISBN-së dhe ISMN-së, në bashkëpunim me Sektorin e Ekzemplarit të detyrueshëm dhe Zyrën e CIP-it (Katalogimi në botim), në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, organizuan takim me botuesit më të mëdhenj të Kosovës.

Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi i përbashkët i çështjeve që kanë të bëjnë me ekzemplarin e detyrueshëm, ISBN, ISMN, dhe CIP, përkatësisht zhvillimin dhe mbarëvajtjen e bashkëpunimit mes BKUK-së dhe botuesve

Botuesit kanë mirëpritur angazhimin e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës për mbledhjen e ekzemplarit të detyrueshëm - si vijimësi në plotësimin e arkivit kombëtare të botimeve në gjuhën shqipe në Kosovë, por, njëkohësisht, shprehën shqetësimin e tyre për moszbatimin e Ligjit për bibliotekat dhe Ligjit për veprimtarinë botuese dhe librin, që, si të tillë, nuk motivojnë veprimtarinë botuese.

## ALEPH 500 në mbarë Kosovën

*Prishtinë, 25 shtator 2007*




Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, duke vlerësuar nevojën e krijimit të një rrjeti unik bibliotekar në tërë Kosovën, ka nisur projektin për implementimin e programit të automatizuar ALEPH 500 edhe në bibliotekat ndërkomunale të Kosovës. BKUK do të japë falas nga një licencë të Programit të automatizuar bibliotekar Aleph 500, për shtatë bibliotekat ndërkomunale, të cilat do të fillojnë t'i fusin të dhënat për njësi në këtë program. Me këtë akt, do të nisë krijimi i një katalogu të përbashkët për tërë Kosovën. Projekti parashihet të shtrihet edhe në bibliotekat e fakulteteve të Universitetit të Prishtinës, si dhe në bibliotekat e veçanta.

Ky projekt është mbështetur nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ndërsa pritet të përkrahet edhe nga institucione të tjera financiare të Qeverisë së Kosovës.



Ceremonia e hapjes së Bibliotekës së Kuvendit të Kosovës

## Themelohet Biblioteka e Kuvendit të Kosovës

*Prishtinë, 10 shtator 2007*

Në një ceremoni solemne, në prani të deputetëve dhe përfaqësuesve të institucioneve, është hapur biblioteka e Kuvendit të Kosovës. Kreu i Kuvendit të Kosovës - Kolë Berisha, solemnisht ka përuruar bibliotekën e Kuvendit të Kosovës, duke theksuar se kjo bibliotekë do t'u shërbejë fuqishëm deputetëve dhe do të jetë në funksion të efikasitetit të punës së tyre në Parlament.

Iniciativa për themelimin e kësaj biblioteke, është pjesë e Memorandumit të Mirëkuptimit mes BKU-së, Kuvendit të Kosovës dhe Projektit "Mbështetje e Kuvendit të Kosovës.

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, ka dhuruar tituj të rëndësishëm të librave në fusha të ndryshme, që mund t'u shërbejnë deputetëve. Gjithashtu, nga stafi profesional i BKUK-së janë udhëhequr trajnime për punëtorët e kësaj biblioteke, si dhe është ndihmuar në katalogimin dhe klasifikimin e fondit të bibliotekës.

Bibliotekës i janë dhuruar 1100 libra nga Universiteti i Oksfordit, si pjesë e ndihmës që është duke dhënë Parlamenti Evropian për Kuvendin e Kosovës.

Përurimin e kësaj biblioteke e kanë përshëndetur edhe dr. Sali Bashota, drejtor i BKUK-së, si dhe udhëheqësi i Projektit për mbështetje të Kuvendit të Kosovës, Huges de Courtivron.

# Donacion i çmuar i librave dhe revistave nga Universiteti i Munihut



Ceremonia e dorëzimit të donacionit të Universiteti të Munihut në BKUK

*Prishtinë, 27 qershor 2007*

Shefi i Zyrës Ndërlidhëse Gjermane në Kosovë, Eugen Wollfarth, si dhe Gjeneral Brigade i KFOR-it, Manfred Hofmeyer – i dorëzuan Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës në Prishtinë, Departamentit të Shkencave Politike të Fakultetit Filozofik, si dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, mbi 1000 libra dhe revista - donacion i Institutit Juglindor të Universitetit të Mynihut.

Ky donacion përfshin përmbajtje të librave dhe revistave në gjuhën gjermane nga: gjuha, kultura dhe historia albanologjike dhe ballkanologjike. "Këto libra dhe revista me autorë kryesisht gjermanë, shkruajnë për Ballkanin dhe do të jenë ndihmesë e madhe për studentët shqiptarë, - tha Eugen Wolfarth, shef i Zyrës Ndërlidhëse të Gjermanisë në Prishtinë.

Në këtë ceremoni morën pjesë: dr. Sali Bashota, drejtor i BKUK-së, akademik Rexhep Ismaili, kryetar i Akademisë, Shkencave dhe Arteve të Kosovës, dr. Ramush Mavriqi, dekan i Fakultetit Filozofik, dr. Enver Hoxhaj, profesor në Departamentin e Shkencave Politike në Fakultetin Filozofik, si dhe përfaqësues të tjerë të institucioneve.

## U rihap biblioteka për të verbrit "Syri Ynë"

*Prishtinë, 14 qershor 2007*

Është rihapur biblioteka për të verbrit në Kosovë "Syri Ynë". Kjo bibliotekë konsiderohet shumë e rëndësishme për personat e kësaj kategorie, të cilët që nga paslufta nuk kanë pasur kushte elementare për përdorimin e literaturës që atyre u nevojitet.

Me ndihmën e Zyrës Amerikane në Prishtinë, biblioteka është pajisur me kompjuterë dhe me literaturë dhe pajisje të alfabetit të brajit, ndërsa për rihapjen e saj, pas 35 vjet të ekzistimit të kësaj biblioteke, ka ndihmuar edhe Ministria e Kulturës e Kosovës. Biblioteka tash i plotëson të gjitha kushtet për përdorim të materialeve dhe është bërë vend i takimeve dhe i aktiviteteve kulturore.

# Hapet Biblioteka Shqiptare në Zvicër

*Cyrih, 3 qershor 2007*

Në Cyrih të Zvicrës është hapur biblioteka e parë shqiptare, e cila është krijuar si rezultat i angazhimit të veprimtarit në Cyrih të Zvicrës - z. Skender Rexhepi, dhe përkrahjes së BKUK, si dhe të institucioneve qeveritare, kulturore, shtëpive botuese etj. nga Kosova.

Biblioteka, e cila 140 metra katrorë hapësirë, ku janë të vendosura fondet, dhe hapësira e vogla për lexim, ka mbi 4 mijë ekzemplarë - botimet më të reja nga Kosova, Shqipëria, si dhe botime të botuesve gjermanë nga Zvicra, shumica donacion nga këto institucione.

Në solemnitetin e hapjes së kësaj biblioteke, kanë marrë pjesë përfaqësues të rëndësishëm politikë e kulturorë nga Kosova dhe Shqipëria: Mehmet Elezi, ambasador i Shqipërisë në Zvicër, dr. Sali Bashota, drejtori i BKUK-së, akad. Esat Stavileci, përfaqësues nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, përfaqësues të lartë të Ministrisë së Kulturës të Kosovës etj.

* * *

Ndërsa me ftesën e drejtorit të Bibliotekës Shqiptare në Zvicër - z. Skender Rexhepi, tre bibliotekarë nga stafi i BKUK-së kanë qëndruar në këtë bibliotekë nga data 7–13. 07. 2007, për të ndihmuar përpunimin e materialeve bibliotekare; klasifikimin sipas KUD-it dhe sipas radhitjes alfabetike - në rafte, të fondit për të rritur dhe fondit për fëmijë.

Janë dhënë udhëzime për inventarizimin e materialeve në mënyrë manuale dhe elektronike dhe udhëzime për politikat e zhvillimit të koleksioneve. Gjithashtu, janë dhënë udhëzime për katalogimin e materialeve dhe etiketimin e tyre; përpunimin e fondit në gjuhë të huaj dhe të fondit të periodikut; anëtarësimin; huazimin; plotësimin i kartelave të librit; radhitjen e kartotekës së lexuesve etj.

## Konferenca e ISMN-së në Oslo



*Presidenti i Agjencisë Ndërkombëtare të ISBN-së, Dr. Hartmut Walravens, mes përfaqësuesve të BKUK-së në Konferencën e ISMN-së*

*Oslo, 31 maj 2007*

Me rastin e mbajtjes së edicionit të 15-të të Konferencës së Kuvendit të Përgjithshëm të ISMN-së (Agjencionit Ndërkombëtar të Numrit Standard Ndërkombëtar të Muzikës) në Oslo të Norvegjisë, morën pjesë përfaqësues të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës - Edona Munishi, muzikologe dhe Besim Kokollari, shef i Qendrës së Bibliotekës Universitare, të cilët në këtë konferencë përfaqësuan Kosovën.

Në këtë Konferencë, janë trajtuar tema me rëndësi, si: rrethanat financiare të ISMN-së për vitin 2006; pagesa e anëtarësisë për agjencitë kombëtare të ISMN-së për vitin 2008 e tutje, në këtë kontekst edhe për Kosovën; raporte për punën e agjencive kombëtare të ISMN-së etj.

Përfaqësuesit e Kosovës kanë bërë një hyrje të gjendjes sa i përket çështjes së agjencisë kombëtare të ISMN-së Kosovë, si dhe kanë njohur përfaqësuesit ndërkombëtarë për veprimtarinë e botimeve muzikore në Kosovë në partitura.

## Ndihmohet me fonde biblioteka "Hendifer"

*Ferizaj, 2 maj 2007*

Nëpërmjet një mbështetjeje ndërbibliotekare, BKUK i ka dhuruar 150 ekzemplarë libra bibliotekës së porsaformuar të personave me aftësi të kufizuara "Hendifer" në Ferizaj.

Biblioteka ndërkomunale e Ferizajt "Anton Çetta", me nismën e së cilës u themelua biblioteka "Hendifer", ka dhuruar 500 ekzemplarë. Këtë institucion e ka ndihmuar me fonde edhe biblioteka ndërkomunale "Latif Berisha" në Mitrovicë.

Xhevat Islami, drejtues i "Hendiferit", u ka dhuruar mirënjohje këtyre institucioneve bibliotekare për ndihmë në themelimin, si dhe pasurimin e fondeve të bibliotekës.

# Përkrahje për BKUK-në në restaurim dhe konservim nga Biblioteka Nacionale e Francës




*Jean Yves Sarazin - ligjëratë e tij në BKUK*

*Prishtinë, 26 prill 2007*

Z. Jean Yves Sarazin, përgjegjës i Restaurimit në Bibliotekën Nacionale të Francës "Francois Mitterrand", ka vizituar BKUK-në dhe Arkivin e Kosovës. Ai është njoftuar për kushtet në të cilat kryhet restaurimi dhe konservimi në këto institucione, duke ofruar ide dhe projekte konkrete për ndihmë teknike dhe aftësim në fusha të veçanta profesionale në Bibliotekën Nacionale të Francës.

Sarazin ka mbajtur ligjëratë për ruajtjen dhe konservimin e materialeve bibliotekare, në prani të përfaqësuesve të bibliotekave, të Arkivit, si dhe të Muzeut të Kosovës. Ai përshkroi format e restaurimit të librave të shtypura dhe manuskripteve të ndryshme të shkruara me dorë, si dhe trajtimeve të dokumenteve të ndryshme nëpërmjet formave moderne digjitale.

* * *

Më 29 qershor 2007, në kuadër të po këtij projekti, si rezultat i bashkëpunimit të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe Bibliotekës Nacionale të Francës "Francois Mitterrand", Bernard Gallois, ekspert, ka mbajtur ligjëratë para një auditoriumi të bibliotekarëve të Kosovës, si dhe ka zhvilluar disa ditë trajnime me stafin profesional për teorinë dhe praktikat e konservimit dhe restaurimit të materialeve bibliotekare, duke prezantuar përvojat dhe teknikat për restaurim të llojeve të ndryshme të materialeve.



*Bernard Gallois*

Gallois ka ofruar ndihmën e tij për zgjerimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të Qendrës, në kohën kur shumë materiale me vlerë në BKUK dhe në Kosovë pritet të restaurohen, për shkak të dëmtimeve që kanë pësuar.



*Moment nga manifestimi për Ditën Ndërkombëtare të Librit*

## Manifestim për Ditën Botërore të Librit

*Prishtinë, 23 prill 2007*

Për herë të parë në Kosovë, nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, është organizuar manifestim për Ditën Ndërkombëtare të Librit dhe e të Drejtës së Autorit. Në këtë manifestim ishin të ftuar: nxënës, studentë, shkrimtarë, studiues, botues, dhe përfaqësues të tjerë të politikës e kulturës.

Nga drejtori i BKUK-së - dr. Sali Bashota, i cili ka hapu këtë manifestim, janë dhuruar simbolikisht 99 libra, siç tha ai - numër simbolik për Kosovën dhe Bibliotekën, - për lexuesit e moshave dhe profileve të ndryshme, duke uruar që kjo ditë të jetë një festë tradicionale që promovon leximin, botimin, si dhe mbrojtjen e pronës intelektuale.

Këtë manifestim e përshëndeti edhe shef i Zyrës Ndërlidhëse të Shqipërisë në Prishtinë, z. Bujar Muharremi, kryetari ShB "Faik Konica", shkrimtari Nazmi Rrahmani etj.

## "BIBLIOGRAFIA E PUNIMEVE PEDAGOGJIKE të botuara në periodikun pedagogjik në gjuhën shqipe mes viteve 1945-1978", BKUK, Prishtinë 2007.




Është bibliografi e parë e punimeve pedagogjike të botuara në gazeta dhe revista pedagogjike në gjuhën shqipe që përfshin një periudhë më të gjatë kohore, e organizuar dhe e sistemuar profesionalisht e autorit Dr. Islam Krasniqit, pedagog shumëvjeçar në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, që trajton probleme nga fusha e shkencës së pedagogjisë shqiptare dhe ajo e përgjithshme. Në të janë përfshirë e sistemuar artikuj dhe punime pedagogjike, të botuara mes viteve 1945-1978, të vjela nëpër gazeta e revista arsimore-pedagogjike në gjuhën shqipe në Kosovë dhe Shqipëri, si: "Shkolla e Re, "Ndihmës i Mësuesit", "Arsimi Popullor, "Mësuesi", "Revista Pedagogjike", "Shkëndija", Përparimi", e shumë të tjera.

Bibliografia është ndarë në X kapituj, të radhitur sipas tematikave pedagogjike, (*sipas disiplinave të veçanta shkencore të pedagogjisë*) duke filluar nga Pedagogjia e përgjithshme, Metodologjia pedagogjike, Historiku i shkollës dhe i mendimit pedagogjik, Historiku i shkollës dhe i mendimit pedagogjik, Pedagogji komparative, Pedagogji parashkollore, Pedagogji familjare, Didaktikë, Metodikë dhe praktikë shkollore, Andragogji dhe Pedagogji speciale. Bibliografia në fjalë përmban 4144 njësi bibliografike, një pjesë e të cilave janë të shoqëruara me sqarime dhe përmbajtje të njësive, të radhitura në 466 faqe. Për një përdorim më të lehtë, bibliografia është pajisur edhe me indeksin alfabetik të autorëve.

## "BIBLIOGRAFI E PUNIMEVE HISTORIKE TË PUBLIKUARA NË KOSOVË GJATË VITEVE 1946-1998", Prishtinë 2006




Kohët e fund it, në ndihmë të shkencës së historisë, studiuesi Dr. Daut Bislimi, sjell para lexuesit bibliografinë me titull: "*Bibliografi e punimeve historike të publikuara në Kosovë gjatë viteve 1946-1998*". Kjo bibliografi është një unitet i integruar i disa punimeve bibliografike të autorit, të botuara periodikisht në shtypin shkencor të Kosovës. Këto punime bibliografike, autori, kryesisht, i ka botuar më herët në vazhdimësi në revistën shkencore të Institutit Albanologjik të Prishtinës "Gjurmime Albanologjike-seria e shkencave historike". Në bibliografi ngërthehen studimet, kontributet dhe materialet, artikujt, vështrimet dhe raportet nga fusha e historisë, të publikuara në revistat e botuara në Kosovë gjatë viteve 1946-1998.

Bibliografia në fjalë është organizuar sipas kritereve të kërkuara bibliografike, mbi parimin alfabetik të renditjes së autorëve dhe artikujve e studimeve të përfaqësuara nga zërat bibliografikë, pavarësisht nga tematika që përfaqësojnë. Për ta bërë bibliografinë sa më të lehtë për përdorim, autori ka përgatitur disa indekse sipas autorëve, sipas personave dhe vendeve për të cilët është shkruar dhe indeksi tematik, duke u bazuar mbi subjektin e çdo artikulli. Kjo bibliografi numëron 1786 njësi bibliografike, të organizuara në 308 faqe. Po ashtu, bibliografia përmban fjalën hyrëse të përgatitur nga recensuesit - Dr. Zekeria Cana dhe Maksim Gjinaj, si dhe parafjalën e përgatitur nga vetë autori. Kjo bibliografi përmban edhe një shtojcë bibliografike të titulluar "*Onomastika e Kosovës - bibliografi*". Puna disavjeçare e autorit, e përmbledhur në një botim të veçantë, do të jetë një ndihmesë për shkencën e historisë, sidomos kur një pjesë e këtyre njësive bibliografike janë publikuar nëpër revista gjatë një periudhë të vështirë politike në Kosovë, e si të tilla kërkimi i tyre, përmes kësaj bibliografie, do të jetë më i lehtë.

## NUMRI STANDARD NDËRKOMBËTAR I LIBRIT: Integrimi në sistemin e ISBN-së, BKUK, Prishtinë 2007.




Ndryshimet e ndodhura në strukturën e ISBN-së dhe futja në përdorim e ISBN 13-shifror që nga janari i vitit 2007, ka bërë të nevojshme që BKUK të përgatitë një manual, në të cilën prezantohen ndryshimet që kanë bëjnë me zgjerimin e numrit 10-shifror në 13-shifror.

Manuali - i përgatitur nga Lavdije Rrahmani, përfaqësuese e ISBN-së për Kosovë, integron edhe informacione nga versioni i ripunuar i ISO-s 2108, i publikuar në vitin 2005. Në të, përveç historikut të ISBN-së, ofrohen edhe informata mbi fillimet e ISBN-së në Kosovë që nga viti 2001 e gjer më sot, si dhe udhëzime për nevojat e botuesve dhe bibliotekës.